



JAVIER SOLANA
Vitet e te jetuarit taktikisht



Jacques Attali
Frika eshte keshilltari me i keq



John Vincour
Nje rol i ri per Gjermanine

Tetor 2014

Politika

Botim elektronik i ASP ne bashkepunim me Bota.al

ZGJOHU EUROPE

Nga George Soros



Programi i Shkollës së Studimeve Politike financohet nga Këshilli i Evropës dhe Zyra e Bashkëpunimit Zviceran në Shqipëri si edhe vetë kontributet e pjesëmarrësve



Botim elektronik i Akademisë së Studimeve Politike në bashkëpunim me Bota.al

bota.al

Friday, June 20, 2014

HOME BOTA EKONOMI TEKNOLOGJI HISTORI SHKENCE KULTURE DOSSIER SPORT

INTERVISTA/Habermas: Propozimi im për një Union më demokratik

Jürgen Habermas është sociolog dhe filozof gjerman, i traditës së teorisë kritike dhe pragmatizmit. Ai është bërë i njohur për teoritë e tij të racionalitetit të komunikimit dhe sferës publike. Sipas sondazheve globale, Habermasi pranohet gjerësisht si një prej...

June 19, 2014

BOTIMESHQIP.COM

Në Shqipëri ju i merrni librat brenda 24 orëve dhe i paguani lehtë në dorë kur merrni librat.

Në çdo vend tjetër të botës ju i merrni librat brenda pak ditësh dhe mund të paguani me PayPal, transferë bankare, etj.

botimeshqip.com
Libri Shqip në shqipëri tani!

Kontaktet:
Akademia e Studimeve Politike
Adresa:
Qendra Kotoni,
Rr.Donika Kastrioti,
Nr.3,
Kati 4, Zyra 2,
Tirane, Shqipëri
Tel: +355 4 227 2173,
Tel: +355 4 450 4788
E-mail: info@asp.al
Web: www.asp.al
dhe www.bota.al

Përzgjedhja, redaktimi dhe përkthimi i materialeve në këtë buletin kryhet nga alumni i Shkollës Shqiptare të Studimeve Politike, z. Ermal Gjinaj



PER POLITIKEN:

Për mua, është e domosdoshme të krijoj një imazh fituesi, kështu që, më duhet të mund dikë...

Richard Nixon

Një prej penalteteve për mospërfshirjen në politikë, është se përfundon të qeverisesh nga njerëz që janë inferiorë

Platoni

Vendet më të errët të Ferrit u janë rezervuar atyre që ruajnë neutralitetin në kohë krize

Dante Aligieri

Politika është lufta pa gjakderdhje, ndërsa lufta është politikë me gjakderdhje

Mao Cedun

Politikanët e këqinj dërgohen të qeverisin, prej njerëzve të mirë që nuk votojnë

William E. Simon



Vitet e të jetuarit taktikisht

JAVIER SOLANA

Taktikat janë zgjidhje afatshkurtëra që shpesh herë kanë pasoja të rëndësishme e të paparashikuara, duke e bërë të pamundur të parashikosh se çfarë lloj bote do të prodhojnë. Strategjia formon një bosht të ndryshëm veprimi, duke marrë parasysh edhe strukturën e ndërvarësisë globale, e si pasojë, se si ndryshime individuale mund të ndikojnë në të gjithë sistemin. Vetëm duke vënë në lëvizje këtë bosht të strategjisë, ne mund të arrijmë botën që duam: një botë të banushme, të qëndrueshme, të lirë dhe të begatë

Ne kemi jetuar në një iluzion. Për vite të tërë, bota ka besuar se tranzicioni nga një rend njëpolar, në një rend shumëpolar do të ishte paqësor, i rregullt dhe i qëndrueshëm, me aktorët e rinj si Kina, Brazili dhe Turqia që do të adaptoheshin me kuadrin ekzistues shumëpalësh, në një mënyrë të natyrshme dhe të harmonis-

hme. Sa shumë që gabohehim!

Në fakt, teksa tranzicioni drejt shumëpolaritetit ka ecur përpara, rendi ndërkombëtar është bërë gjithnjë e më i paqëndrueshëm dhe në tension. Kriza financiare globale e vitit 2008 solli pasiguri dhe mosbesim, duke dëmtuar tendencat kyçe, si globalizimi. Por problemi më i madh ka qenë dështimi i vendeve të zhvilluar – arkitektët e rendit ndërkombëtar të pas Luftës së Dytë Botërore – për të formuluar një strategji gjithëpërfshirëse për të përballuar sfidat globale dhe për të kontrolluar tranzicionin drejt një sistemi të ri ndërkombëtar.

Arsyeja për këtë dështim është e thjeshtë: Perëndimi ka lejuar që shqetësimet taktikë afatshkurtër të pengojnë zhvillimin e një vizioni strategjik afatgjatë. Ky fiksion pas taktikës ka patur ndikim në qeverisje në të gjithë nivelet, që nga administratat lokale deri tek institucionet ndërkombëtare, duke lejuar aktorë të mëdhenj të veprojnë brenda realiteteve të pakoordinuar, dhe pa objektiva të përbashkët për të udhëhequr vendim-marrjen e tyre.

Sigurisht, ka patur disa përjashtime që ia vlen të shënohen, që kanë ardhur për shkak të përpjekjeve të bashkërenduara për të konsoliduar një vizion strategjik konstruktiv. Për shembull, politika perëndimore ka bërë përparim sa i përket gjetjes së një zgjedhjeje për programin bërthamor të Iranit.

Por në fusha të tjera, mendimi strategjik ka patur mangësi. Për shembull në Ukrainë, konflikti ka ekspozuar dhe ka zgjeruar tensionin mes Rusisë dhe Perëndimit. Beteja e Rusisë post-sovjetike për t'u integruar në rendin ndërkombëtar, bashkë me refuzimin që ajo i bën modernizimit, kanë nxitur një nacionalizëm revizionist të bazuar mbi sferat e influencës.

Dhe nuk është vetëm Rusia që i ka kthyer shpinën modernitetit perëndimor.

Lindja e Mesme ka qenë një vatër e nxehtë paqëndrueshmërie të nxitur prej tensioneve historikë, që në shembja e perandorisë otomane një shekull më parë. Tani është mbështjellë nga flakët – kjo edhe për faktin se ndërhyrjet e përsëritura të perëndimit atje janë udhëhequr prej shqetësimeve taktikë dritëshkurtër.

Në të vërtetë, udhëheqësit perëndimorë nuk arritën të parashikojnë pasoajat afatgjata të mbështetjes së autokracive, që u zbuluan gjatë revoltave të pranverës arabe, apo të parashikonin impaktin e ndërhyrjeve të njëpasnjëshme ushtarake në Irak, Siri dhe Libi. Si rezultat, nostalgjia për të kaluarën “e lavdishme” – si për shembull zilia e Shtetit Islamik për kalifatit – po përhapet dhe në Lindjen e Mesme.

Perëndimi nuk ishte i përgatitur për forca globale që shtynin prapa dhe që kërkonin një të ardhme tek e kaluara. Në çdo rast, Lindja e Mesme duhet të lejohet që të marrë “pronësinë” e zgjidhjeve për sfidat me të cilat ndeshet; në fund të fundit, asnjë zgjidhje e imponuar nga jashtë nuk ka funksionuar deri më sot. Përgjegjësia e pjesës tjetër të botës është të ndërtojë një pikëmbështetje të fuqishme për këto përpjekje: një sistem ndërkombëtar gjithëpërfshirës, ku shtetet veprojnë bazuar mbi të njëjtët rregulla dhe norma.

Në menaxhimin e tranzicionit drejt shumëpolaritetit, sfida më e madhe e Perëndimit qëndron në Azi – një rajon që është njëkohësisht dinamik dhe i orientuar nga e ardhmja, si dhe i penguar prej tensioneve dhe ndarjeve historike. Duke pranuar rëndësinë e thellë që ka Azia për rendin botëror, presidenti i SHBA, Obama shpallti një politikë të re të “drejtimit për nga Azia” në vitin 2012.

Por udhëheqësit perëndimorë kanë hezitur ta integrojnë Kinën, aktorin më të fuqishëm ekonomik në Azi, brenda sistemit ndërkombëtar. Në të vërtetë, takimi i fundit i Fondit Monetar Ndërkombëtar – që pranoi se Kina është ekonomia më e madhe për nga pariteti i fuqisë blerëse – e arriti këtë konkluzion pa e rritur peshën e votave të Kinës. Për ta vënë në perspektivë, Kina u la me vetëm pak më shumë vota se Italia, ekonomia e të cilës është sa një e pesta e madhësisë, dhe ka një të katërtën e votave të Amerikës.

Veç kësaj, perëndimi ka kaluar në plan të dytë mbështetjen për krijimin dhe for-

cimin e kuadreve rajonalë të bashkëpunimit, në fusha kyçe si siguria. Si rezultat, mosmarrëveshjet territoriale dhe pretendimet nacionaliste mbeten një rrezik i fortë për stabilitetin rajonal dhe global.

Por, për Perëndimin, zbatimi i një vizioni afatgjatë kërkon më shumë se sa pranimin e imperativit të vendim-marrjes strategjike; ai kërkon gjithashtu përpjekje për të rivitalizuar sistemet e brendshëm politikë, të polarizuar dhe jofunksionale. Në SHBA, nuk ka dyshim se mungesa e vizionit strategjik që ka shfaqur politika e jashtme e Obamës është të paktën pjesërisht rezultat i nevojës së tij për të “lun-druar” me një sistem defektoz.

Nga ana e tij, Bashkimi Europian ka ndjekur politika dritëshkurtëra përballë sfida-ve ekonomike, pa parashikuar – dhe pranuar – pasojat sociale dhe politike, duke përfshirë edhe përhapjen e ndjenjave antiBE. Qasja taktike e shteteve anëtarë ndaj problemeve të tyre të veçantë (shpesh herë të përcaktuar prej statusit të tyre si kredidhënës apo kredimarrës) e ka lënë Europën pa një lidhësi të besueshëm dhe një vizion të unifikuar. Një qasje më strategjike do të fokusohet në nxitjen e rritjes ekonomike në të gjithë BE-në, si për shembull duke përmbushur objektivat e Europe 2020 për kërkimin, zhvillimin dhe inovacionin, si dhe për çuarjen përpara të Partneritetit Transatlantik për Tregtinë dhe Investimet.

Taktikat janë zgjidhje afatshkurtëra që shpesh herë kanë pasojë të rëndësishme e të paparashikuara, duke e bërë të pamundur të parashikosh se çfarë lloj bote do të prodhojnë. Strategjia formon një bosht të ndryshëm veprimi, duke marrë parasysh edhe strukturën e ndërvarësisë globale, e si pasojë, se si ndryshime individuale mund të ndikojnë në të gjithë sistemin. Vetëm duke vënë në lëvizje këtë bosht të strategjisë, ne mund të arrijmë botën që duam: një botë të banueshme, të qëndrueshme, të lirë dhe të begatë. /Project Syndicate/

** Javier Solana ka qenë Përfaqësues i Lartë i BE për Politikën e Jashtme dhe Sigurinë, Sekretar i Përgjithshëm i NATO-s dhe Ministër i Jashtëm i Spanjës.*



Rikthim në Berlin, 1989

Roger Cohen

Shkova për një shëtitje në Berlin. Gjethet e vjeshtës zverdhin pemët, me shtëpizat e drunjta të zogjve. Rrugët me më shumë hapësira se sa njerëz, që “përgënjeshtrojnë” atë epitet të cekët, kryeqyteti i Europës. Sapo isha ndarë me një mikun tim në Grunevald, i cili më tha se shtëpia e tij ishte ndërtuar në vitin 1930, nga një familje hebrejsh, e cila ishte arratisur për në Brazil në vitin 1936. Një herë, ai i kishte treguar shtëpinë mbesës së pronarit të parë të saj, dhe më pas kish bërë të njëjtën gjë me pasardhësit e oficerit britanik që kish jetuar në këtë shtëpi pas vitit 1945. Jeta, siç e dinë mirë arkeologët, e rrëfen historinë e saj me shtresa; dhe askund më shumë se sa në këtë qytet. Një zonjë gjermane më tha se kur kishte hequr letrën e murit në apartamentin e saj kishte gjetur gazeta me tituj që festonin ditëlindjen e Fyhrerit në vitin 1937. Një epitet më i mirë do të ishte, Berlini, kryeqyteti i kujtesës.

Atëherë, si duhet kujtuar 25-vjetori i rënies së Murit të Berlinit – fundi i ndarjes së Gjermanisë, dhe Europës, dhe botës? Ka kaluar një gjysmë shekulli. Shekulli i përgjakshëm që kaloi është tërhequr dhe mbuluar nga mjegulla. Rënia e murit nuk ishte fundi i historisë, por agrimi i një historie të ndryshme. Ai nuk na futi në një epokë ku interesi i iluminuar vetiak do të qeveriste marrëdhëniet mes

kombeve të bashkuar në demokraci liberale. Format e nacionalizmit nuk vdiqën aspak, përkundrazi, u rigjallëruan. Fanatizmi gjeti tokë pjellore në toka shkretëtirash. Rusia u ringrit duke hungërirë. Megjithatë, sigurisht kjo ishte, sipas fjalëve të Wolfgang Schauble, ministër i jashtëm i Gjermanisë, “momenti më fatlum në historinë tonë”, një ritakim pothuajse i paimagjinueshëm i Gjermanisë me vetveten. Për miliona banorë të Europës qendrore dhe lindore, ishte edhe momenti i çlirimit nga morsa sovjetike.

Gjermania tani gumëzhin si këta tramvaje qytetesh. Bashkimit iu desh një brez i tërë, ai ishte i vështirë, por ndodhi. Në një epokë përshtatjesh politike minutë-pas-minute, ky vend na kujton se është mirë të vendosësh objektiva afatgjatë dhe t’u përmbahesh atyre. Procesin e ndihmoi federalizmi. Po kështu edhe premtimi i Kushtetutës për “Lebensverhaeltnisse” (kushte jetese) të barabarta për të gjithë gjermanët. Këtu të pasurit janë pasuruar më shumë, ashtu si kudo, por me më pak turp. Socialdemokracia nuk është një ide boshe në një komb, eksperiencia e të cilit me mëkatin i ka dhënë një leksion të pashlyeshëm për rreziqet e frakturës sociale.

Jashtë Gjermanisë, historia europiane është më pak e lumtur. Pas një çerek shekulli, pyetjet e ngritura nga bashkimi i Gjermanisë dhe një Europë tashmë një e tërë nuk kanë gjetur përgjigje. Greqia është me xhepat bosh, Franca e zhytur në zymtësi, Bashkimi European ka ngecur. Gjermania dominon Europën, një rol i cili nuk i pëlqen edhe pse nuk është immune nga emocionet e herëpashershëm. Me këtë dominim, janë rikthyer tundimet e vjetër intelektualë: ideja e të qënurit një fuqi e madhe, e barazlartuar nga Rusia dhe SHBA.

Aderimi i Gjermanisë në Union dhe NATO është ende i padiskutueshëm. Por lufta e vogël e Rusisë në Ukrainë dhe aneksimi prej saj i Krimesë ka zbuluar simpatizues të Putinut në të majtë e në të djathtë, të nxitur edhe prej ndjenjave antiamerikane.

Ashtu sikurse ukrainasit, sipas fjalëve të Joschka Fischerit, një ish ministër i Jashtëm, “vdisnin të ishin pjesë e Europës”, Europa ka rezultuar e padenjë për sakrificën e tyre, për shkak të varësisë energjetike nga Rusia. Ajo që ukrainasit duan sot nuk ndryshon nga ajo që gjermano-lindorët dhe polakët kërkonin në 1989-ën. Kujtimet venë e vijnë pa ndonjë drejtim të caktuar, si gjethet e vjeshtës që bien përgjatë Hohenzollerndamm. Unë erdha në vitin 1998 në një Berlin ende jo të



rilindur si kryeqytet i Gjermanisë, ende i ndarë në mentalitet. Vitin tjetër, në për-
vjetorin e dhjetë, bisedova me Harald Jaegerin, rojen kufitare që hapi portën duke
i dhënë kështu fund ndarjes së Europës, në 9 nëntor 1989. E pyeta se si ishte
ndier: “Djersët më rridhnin çurk në qafë dhe këmbët më dridheshin. E dija çfarë
kisha bërë. Isha menjëherë i vetëdijshëm. Kaq e pat, mendova, Gjermania Lindore
mori fund”.

Nuk do të kish marrë fund pa vendosmërinë e Amerikës dhe aleatëve të saj.
Mbështetja e palëkundur e Amerikës për bashkimin e Gjermanisë, dhe madhësh-
tia diplomatike e James Bakerit, në atë kohë Sekretar Shteti i SHBA, e shndërruan
një të çarë të murit, në një rend të ri i cili çliroi gjysmën e Europës dhe u pranua
nga Moska. Një diplomaci e tillë, plot forcë dhe kthjelltësi nevojitet shumë sot,
nga Ukraina në Irak. Një brez i ri po mëson se të qëndrosh mbi ujë dhe të shpre-
sosh për më të mirën nuk mjafton. Shpresa nuk është politikë. Bota është e
rrezikshme. Aleancat kanë rëndësi, ashtu si angazhimet dhe vijat e kuqe.

Për nder të Bakerit, marrësi këtë vit i çmimit Kissinger në Akademinë Amerika-
ne në Berlin, Hans-Dietrich Genscheri, ministri i Jashtëm i Gjermanisë në 1989,
tregoi se ndërkohë që turmat iu vërsulën murit, ai i telefonoi Bakerit, që nga
ministra e tij në Bonn. Operatorja telefonike arriti Sekretarin e Shtetit. Përpa-
ra se Genscheri të fillonte të fliste, ajo shpërtheu: “Z. Sekretar, Zoti e Bekoftë
Amerikën!”

Vetëm berlinezi më i shkujdesur do të mund t’i harronte ndonjëherë këto fjalë. /
NYT/

PERSHTATUR NE SHQIP NGA www.bota.al



Përballë krizave, Frika është këshilltar i keq

Jacques Attali

“Diçka do të ndodhë”. Ose cili është sekretetë i vërtetë i të ardhmes? Të mos jesh i frikësuar nga armiqtë, ky është sekretetë i vërtetë i të ardhmes. Ky është sekretetë i popujve të lumtur

Duhet të jesh një mohues i madh, siç kanë qenë këto kohë shumica e udhëheqësve europianë, që të mos shohësh se diçka e madhe do të ndodhë në Europë në muajt që do të vijnë. Njëra prej disa shpatave të mëdha të Demokleut që rrijnë varur në qiellin e historisë, do të biën mbi kokën tonë:

Lëvizjet e ndryshme terroriste që veprojnë në Lindjen e Mesme, ku stërvisin kopjet e tyre, mund të realizojnë në kontinentin tonë sulmet terroristë me të cilët na kanë kërcënuar.

Epidemia e Ebolës në Afrikën Perëndimore mund të marrë përmasa të mëdha dhe në fun të prekë Europën me një imakt të rëndësishëm, duke shkaktuar një rënie

të madhe në shumë forma të tjera shkëmbimesh.

Situata politike dhe financiare në Kinë, gjithnjë e më e paqëndrueshme, mund të shkaktojë një krizë të madhe ekonomike atje, me një impakt të konsiderueshëm mbi ekonominë globale, dhe veçanërisht Europën.

Zhytja prej kohësh e SHBA në borxh dhe printimi i parave, për të arritur vetëm një rritje ekonomike të vogël mund të dështojë në shpëtimin e një sistemi financiar tërësisht të çbalancuar, ku edhe këtu pasojat për Europën do të ishin të rënda. Për ta thënë në mënyrë më të drejtpërdrejtë, situata e përgjithshme në Europë, e cila po zhytet në deflacion, e bën shumë të mundshëm skenarin ku një prej shteteve të Bashkimit European falimenton, për shkak të humbjes së aftësisë për pagimin e borxhit. Dhe zemërimi i gjermanëve, përballë rrëshkitjes së të tjerëve, mund ta detyrojë këtë vend që të bëhet i pari që lë lë eurozonën.

Veç kësaj, vendimi i pritshëm i Gjykatës Europiane në lidhje me mekanizmin e solidaritetit të bonove, krijuar nga Mario Draghi, nëse do të shpallet se bie ndesh me traktatet europiane, mund të shkaktojë dorëheqjen e Presidentit të Bankës Qendrore Europiane dhe një kolaps të Euros.

Më konkretisht Franca, defiçiti buxhetor i të cilës tashmë ka dalë jashtë kontrolli dhe ku reformat vijnë shumë ngadalë, mund të sulmohet prej tregut dhe të humbasë aftësinë paguese.

Të paktën njëri prej këtyre rreziqeve ka gjasa të materializohet në 18 muajt e ardhshëm. Të gjithë dyshojnë dhe të gjithë përgatiten, secili në mënyrën e vet. Sidomos në Francë. Dhe për këtë, dy qasje janë të mundshme:

E para, më e shpeshtë dhe me më shumë gjasa, është pasojë e frikërave të të tjerëve. Ajo çon në mbylljen e kufijve, në izolacionizëm, refuzim i të resë dhe i të tjerëve, domethënë çon në iluzionin e arratisjes nga kaosi që ka mbështjellë botën. Ajo do të shkaktojë një tjetër tronditje, duke i dhënë pushtet në Francë Frontit Nacional, në një apo dy rajone gjatë zgjedhjeve të ardhshme të qershorit. Dhe duke qenë se ata nuk do të përmirësojnë cilësinë e jetës për veriorët, mund të shpjegojnë që nuk mund të bëjnë asgjë nëse nuk qeverisin të gjithë Francën, një skenar që bëhet më i mundshëm me çdo ditë që kalon. Për fatkeqësinë e vendit, për shkak të barrierave të pafuqishme që do të ngrinte një qeveri e frikës, kjo do të përmytej shumë shpejt nga cunami që pritet të vijë.

Qasja e dytë është t'u paraprihet këtyre rreziqeve, të kuptohet se frika është një këshilltar i keq, se strehimi në izolacionizëm nuk do të jetë përgjigje, se refuzimi i të tjerëve është vetëvrasje, se begatia e ardhshme e Francës do të varet prej mbajtjes nën kontroll të borxhit, nxitjes së inovacionit dhe arsimit, prej integritit të suksesshëm të atyre që duan t'i bashkohen këtij vendi. Europa mundet dhe duhet të organizohet në mënyrë urgjente, me qëllim që t'u rezistojë këtyre krizave, të marrë masat e domosdoshme për të investuar, duke ulur vlerën e Euros dhe duke monitoruar në mënyrë të përbashkët kufijtë.

Të mos jesh i frikësuar nga armiqtë, ky është sekreti i vërtetë i të ardhmes. Ky është sekreti i popujve të lumtur.

PERSHTATUR NE SHQIP NGA www.bota.al



Një rol i ri për Gjermaninë

John Vincour

Kur Holanda, Belgjika dhe Danimarka vendosën të kryejnë misione bombardimi mbi Irak, përkrah SHBA, kundër forcave terroriste të Shtetit Islamik, me këtë vendim po zgjidhnin të merrnin një krah në një përplasje jo të vegël. Tre demokraci të vogla po pranonin edhe rrezikun e lartë të veprimeve terroriste në vendet respektivë edhe qëllimin e Barak Obamës për të “shkatërruar” ISIS-in përmes një fushate që ndoshta mund të kërkojë vite.

Gjermania, aleati i madh në NATO dhe fqinji i këtyre tre vendeve nuk u bashkua me ta. Ministri i Jashtëm gjerman, Steinmeier, tha në 11 shtator se “se as nuk na është kërkuar të bëjmë diçka – dhe as do ta bëjmë”. Kjo quhet “fuqi pa angazhim”.

Ishte kjo shprehja që u përdor javën e kaluar nga një zyrtar i lartë europiano-perëndimor për të përshkruar qasjen joluftarake të Berlinit, në një kohë kur është betuar për “përgjegjshmëri” dhe aktivizëm në çështjet ndërkombëtare, pas vitesh të tërë angazhimi të matur.

Një shembull: Ndërkohë që Australia dhe Kanadaja sinjalizuan gjatë fundjavës gatishmërinë për t’u bashkuar në sulmet ajrorë të koalicionit anti-ISIS, Gjermania tha se po konsideronte idenë e dërgimit të oficerëve për të stërvitur forcat kurde dhe irakene. Nëse do të ndjekë modelin e kufizuar të angazhimit në Afganistan,

do të thotë se oficerët gjermanë nuk do të shoqërojnë ata që stërvisin në betejë. Kjo gjë pason ekspozimin e gjendjes së keqe brenda forcave të armatosura të Gjermanisë. Tani ne e dimë se vetëm një në katër nëndetëse gjermane funksionojnë normalisht dhe që një numër i madh avionësh gjuajtës dhe helikopterësh ushtarakë gjermanë nuk funksionojnë. Avioni i tij i transportit “Transall” është shumë i vjetër, aq sa xhaxhai i mamasë së vajzës sime ka pilotuar një të tillë në fillimin e viteve 1970.

Po kështu, sondazhet tregojnë se gjermanët kanë shumë pak interes për një angazhim më të madh kundër ISIS-it. Këtu ngrihet një pyetje e vjetër: Si mund të mbështetet perëndimi tek aktori kryesor në Europë, kur ky vend është kaq hezitues për t’u ngritur në këmbë në emër të sigurisë së perëndimit?

Por tani ka një tjetër kontekst për ta ngritur këtë pyetje: një ekonomi gjermane e cila ka pushuar së rrituri. Kjo lë të kuptohet se lidhshipi i vendit, i cili është thelbësishëm i lidhur me besueshmërinë ekonomike, po dëmtohet dyfish.

Felix Huefner, një ekonomist gjerman që ka qenë kreu i zyrës gjermane në OECD, ka luajtur një rol kyç në zhvillimin e modeleve ekonomike nga ana e agjencisë ndërkombëtare, të cilët e paraqesin Gjermaninë, pa reformat e mëdha, në stancion përgjatë 25 viteve të fundit.

Tashmë zëvendës drejtor në Institutin e Financës Ndërkombëtare në Uashington, Huefner më tha: “Rritja potenciale ekonomike vjetore e Gjermanisë me shumë gjasa do të bjerë nën 1% duke filluar nga viti 2020. Kjo do të jetë normalja e re”. Rrethanat nuk janë të pashpresa – një fuqizim i investimeve të brendshëm do të bënte dallimin – por këta kërcënojnë legjitimitetin gjerman. Realiteti thotë se Kancelarja Angela Merkel do të detyrohet të bëjë ndryshime të menjëhershëm, përballë një elektorati të cilin ajo e ka bindur, se ndershmëria gjermane është Rruga e Ndriçuar drejt mirëqenies ekonomike të botës.

Kombinuar me një situatë ekonomike të përkeqësuar, vendi i Gjermanisë si një invalid strategjik dhe ushtarak paraqet një problem të vërtetë. Camille Grand, Drejtore e Fondacionit Francez për Kërkime Strategjike, thotë se përballë shtytjeve nga Rusia, Gjermania është shndërruar në flamurbajtësen e demilitarizimit të Europës, intelektualisht dhe praktikisht”.

Edhe gjermanët janë po kaq thumbues. Alexander Lambsdorff, zëvendës president i Parlamentit Europian, deklaroi në 28 shtator se pazotësitë e ushtrisë gjermane kanë qenë të njohura prej kohësh nga aleatët “të cilët nuk e llogarisin më Gjermaninë, kur vjen puna tek dominimi i krizave ndërkombëtare”. Gjermania të dominojë ushtarakisht krizat? Mjaft bëtë shaka!



Qeveria e Berlinit ofroi në mënyrë të pavetëdijshme një shpjegim të arsyes. Zëdhënësi i Merkelit deklaroi të enjten se Gjermania do të kërkonte presidencën e radhës të OSCE, anëtarët e të cilës përfshijnë SHBA dhe Rusinë, dhe e cila mbikëqyr përpjekjet për ndërmjetësim në situata si luftimet mes Ukrainës dhe rebelëve që kontrollohen nga Rusia në lindje të vendit.

Për mua, kjo i jep një rol ndërmjetësues Gjermanisë në këtë konflikt, përjash-ton mbështetjen aktive të Gjermanisë për Ukrainën, dhe si ndërmjetës zyrtarë, nënkupton që gjermanët mund të bëjnë të dy palët njësoj përgjegjëse për luftën. Kjo punë më mirë t'i lihej Andorrës.

Por i shkon shumë mirë për shtat vetëcaktimit të Gjermanisë si ndërmjetëse mes Uashingtonit dhe Moskës, gjë që ishte shprehur në mënyrë eksplicite në manifestin e socialdemokratëve të Steinmeyerit vitin që kaloi. Kjo është po aq e papërgjegjshme sa edhe përpjekja e Gjermanisë për të injoruar shtesën më të fundit që i ka bërë Rusia doktrinës së saj të mbrojtjes, që specifikon përdorimin e hershëm të armëve bërthamore taktike në konfliktet rajonale.

Po kështu, shkon fare mirë me heshtjen e Gjermanisë, kur Rusia dërgoi vitin që kaloi raketa Iskander në enklavën e vet në Kaliningrad, mes dy anëtarëve të NATO-s, Polonisë dhe Lituanisë. Cfarë mund të bëjë SHBA dhe miqtë e vet ndaj një aleati të tillë, gjithnjë e më të tërhequr?

Në kohën e administratës së Reaganit, Sekretari i Mbrojtjes Caspar Weinberger i qetësoi një herë gjermanët duke hequr fjalën “fitojë” dhe duke thënë që në një konflikt bërthamor Amerika synon thjeshtë “të mbizotërojë”.

Obama ka deklaruar që dëshiron të shkatërrojë Shtetin Islamik. A është në rregull kjo shprehje sipas jush, zonja Kancelare? /The Wall Street Journal/
PERSHTATUR NE SHQIP NGA www.bota.al



Zgjoju Europë!

George Soros

Eshtë koha që Bashkimi European të hedhë një vështrim kritik nga vetvetja. Duhet të ketë diçka që nuk shkon në BE, përderisa Rusia e Putinit është kaq e suksesshme, edhe në terma kohëshkurtër. Burokracia e BE nuk ka më monopolin e pushtetit dhe ajo ka shumë pak arsye për të qenë krenare. Duhet të mësojë të jetë më e bashkuar, fleksibël dhe efiçiente. Dhe vetë europeanët duhet të shohin më nga afër Ukrainën e re. Kjo do i ndihmonte të rrokjin frymën që mbizotëronte atëherë kur krijohet Bashkimi European. Duke shpëtuar Ukrainën, Bashkimi European do të shpëtonte vetveten

Europa po përballet me një sfidë nga Rusia, ndaj vetë ekzistencës së saj. As udhëheqësit europianë, as qytetarët e Europës nuk janë plotësisht të vetëdijshëm për këtë sfidë, dhe as nuk dinë si ta përballojnë atë. Mendoj se shkak i kësaj është

fakti se Bashkimi European në përgjithësi dhe eurozona në veçanti e kanë humbur rrugën, pas krizës financiare të vitit 2008.

Rregullat fiskalë që mbizotërojnë aktualisht në Europë kanë shaktuar shumë pakënaqësi popullore. Partitë antiEuropë kanë arritur pothuajse 30% të vendeve në zgjedhjet e fundit për Parlamentin European, por deri kohët e fundit ato nuk kanë patur një alternativë ndaj BE-së për të parashtruar. Tani Rusia po ofron një alternativë që paraqet një sfidë themelore ndaj vlerave dhe parimeve mbi të cilat u ngrit Bashkimi European që në krye të herës. Ajo bazohet në përdorimin e forcës, që manifestohet në shtypjen brenda vendit dhe agresionin jashtë tij, përkundër sundimit të ligjit. Ai që të trondit është fakti që Rusia e Vladimir Putinit ka rezultuar në disa drejtime superiore ndaj Bashkimit European – më fleksibël dhe një burim konstant befasis. Kjo i ka dhënë një avantazh taktik, të paktën në terma kohëshkurtër.

Europa dhe Shtetet e Bashkuara – secila për arsyet e veta – janë të vendosura që të shmangin çdo konfrontim të drejtpërdrejtë ushtarak me Rusinë. Rusia po e shfrytëzon hezitimin e tyre. Duke shkelur detyrimet e veta në marrëveshje, Rusia ka aneksuar Krimenë dhe ka krijuar enklava separatiste në Ukrainën lindore. Në gusht, kur qeveria e krijuar së fundmi në Kiev rrezikoi të fitojë luftën e nivelit të ulët në Ukrainën lindore kundër forcave separatiste të mbështetura nga Rusia, presidenti Putin pushtoi Ukrainën me forca të rregullta ushtarake, në shkëlqje të hapur të ligjit rus që përjashton rekrutët nga shërbimi i jashtëm, pa miratimin e tyre.

Në 72 orë, këto forca shkatërruan disa qindra mjete të armatosur të ushtrisë ukrainase, që ishte një pjesë e rëndësishme e forcës së saj luftuese. Sipas gjeneralit Wesley Clark, ish Komandant i Përgjithshëm i Forcave të NATO-s në Europë, rusët kanë përdorur disa sisteme të lëshimit të raketave të pajisur me municione që thërrmohen si dhe me koka termobarike (një armë edhe më çnjerëzore që duhej të kish dalë jashtë ligji) me një efekt shkatërrimtar. Ushtarakët vendas nga qyteti ukrainas i Dnepropetrovskit pësuan më shumë humbje, sepse ata komunikonin me celularë dhe si pasojë vendondodhja e tyre gjendej lehtësisht prej rusëve. Deri tani, Presidenti Putin e ka zbatuar një marrëveshje armëpushimi me presidentin ukrainas, Petro Poroshenko të firmosur në 5 shtator, por Putini ruan të drejtën ta vazhdojë armëpushimin sa kohë që e sheh në avantazh të tijin, ose përkundrazi të nisë një sulm në shkallë të gjerë.

Në shtator, Presidenti Poroshenko vizitoi Uashingtonin ku pati një mikpritje entuziaste gjatë një seance të përbashkët në Kongres. Në fjalimin e tij, ai kërkoi armë mbrojtëse “vdekjeprurëse dhe jo vdekjeprurëse”. Megjithatë, presidenti Obama refuzoi kërkesën e tij për raketa Javelin, që mund të përdoren kundër tankeve që përparojnë. Poroshenkos iu dhanë radarë, por për se mund të përdoren ata pa raketa? Vendet europiane janë njësoj hezitues që të ofrojnë ndihmë ushtarake për Ukrainën, nga frika e një reagimi të Rusisë. Vizita në Uashington i dha presidentit Poroshenko një fasadë mbështetjeje, por me shumë pak përmbajtje.

Po kaq shqetësuese ka qenë vendosmëria e udhëheqësve zyrtarë ndërkombëtarë për të ndalur angazhimet e tyre financiarë ndaj Ukrainës, deri pas zgjedhjeve të 26 tetorit atje. Kjo ka shaktuar një trysni të shmangshme ndaj rezervave të valutës në Ukrainë si dhe ka shtuar frikën për një krizë financiare të rëndë në vend.

Tani ka rritje të presionit nga donatorët, në Europë apo në SHBA, për “dorëzimin” e mbajtësve të bonove të borxhit sovran ukrainas, domethënë që këta të marrin përsipër humbjet në investimet e tyre, si parakusht për vazhdimësinë e asistencës zyrtare për Ukrainën, gjë që do të vinte në rrezik paratë e taksapaguesve. Ky do të ishte një gabim i rëndë. Qeveria e Ukrainës e kundërshton me forcë këtë propozim, pasi ai do të çonte Ukrainën drejt një falimenti teknik, e si pasojë

do ia bënte të pamundur sektorit privat të rifinanconte borxhin e saj. Dorëzania e kredidhënësve privatë do të kursente shumë pak para dhe do ta bënte Ukrainën tërësisht të varur nga donatorët zyrtarë.

Për t'i ndërlikuar gjërat, Rusia po përdor njëkohësisht karrotat dhe shkopinj të. Ajo po ofron – por nuk po firmos – një marrëveshje për furnizimin me gaz që do të plotësonte nevojat e Ukrainës për dimrin. Në të njëjtën kohë, Rusia po përpiqet të pengojë furnizimin me gaz që Ukraina e siguron prej tregut europian, përmes Sllovakisë. Në po të njëjtën mënyrë, Rusia po negocion me OSCE-në për monitorimin e kufijve, ndërkohë që vazhdon të sulmojë aeroportin e Donetskut si dhe portin e Mariupolit.

Eshtë e lehtë të parashikosh se çfarë rezervon e ardhmja. Putini do të presë rezultatin e zgjedhjeve të 26 tetorit dhe më pas do i ofrojë Poroshenkos gazin dhe të tjerat që ai ka kërkuar, me kushtin që ky të emërojë një Kryeministër të pranueshëm për Putinin. Kjo do të përjashtonte këdo që është i lidhur me fitoren e forcave që rrëzuan qeverinë e Viktor Yanukovichit duke rezistuar për muaj të tërë në sheshin Maidan. Mendoj që nuk ka gjasa që Poroshenko të pranojë një ofertë të tillë. Nëse e bën, do të humbasë mbështetësit e Maidanit; pas kësaj do të ringjallëshin forcat e rezistencës.

Pas kësaj, Putini do të preferonte fitoren më të vogël, që ende mund ta arrijë: ai do të hapte me forcë një rrugë tokësore nga Rusia në Krime dhe Transnistri, përpara dimrit. Përndryshe, ai thjeshtë mund të ulet dhe të presë kolapsin ekonomik dhe financiar të Ukrainës. Dyshoj që ai mund të presë për mundësinë e një ujdje të madhe, ku Rusia do të ndihmonte SHBA kundër ISIS-it – për shembull duke mos furnizuar Sirinë me raketat S300 që i ka premtuar, duke ruajtur kështu dominimin ajror të SHBA – dhe në këmbim Rusia do të lejohej të kishte kontrollin e saj në fqinjësinë e afërt. Dhe më e keqja është që Presidenti Obama mund ta pranojë një ujdje të tillë.

Ky do të ishte një gabim tragjik, me pasoja gjeopolitike të mëdha. Pa nënvlerësuar rrezikun që vjen nga ISIS, do të argumentoja se ruajtja e pavarësisë së Ukrainës duhet të ketë përparësi; pa të, edhe aleanca kundër ISIS do të shpërbëhej. Kolapsi i Ukrainës do të ishte një humbje e rëndë për NATO-n, Bashkimin Europian dhe Shtetet e Bashkuara. Një Rusi fitimtare do të kishte shumë më tepër ndikim brenda BE-së dhe do të paraqiste një rrezik të madh ndaj shteteve balltike me pakicat e mëdha etnike ruse që ata kanë. Në vend të mbështete Ukrainën, NATO-s do i duhej të mbronte vetveten, në tokën e saj. Një gjë e tillë do të ekspozonte SHBA dhe BE ndaj rrezikut që aq shumë kanë dashur ta shmangin: një konfrontim i drejtpërdrejtë ushtarak me Rusinë. Bashkimi Europian do të bëhej edhe më i përçarë dhe i paqeverisshëm. Përse duhet që SHBA dhe vendet e NATO-s të lejojnë të ndodhë kjo?

Argumenti që ka mbizotëruar edhe në Europë, edhe në SHBA, është se Putini nuk është Hitleri; duke i dhënë gjithçka që ai kërkon në mënyrë të arsyeshme, mund të parandalohet përdorimi prej tij i forcës. Në ndërkohë, sanksionet kundër Ruisë – që përfshijnë, për shembull, kufizime të transaksioneve të biznesit, financës dhe tregtisë – do të kenë efektin e tyre dhe në terma kohëgjatë, Rusia do të duhet të sprapset me qëllim që këta sanksione t'i lehtësohen pak.

Janë shpresa të rrejshme që burojnë prej një argumenti po kaq të rrejshëm dhe pa prova faktike ku të mbështeten. Putini ka përdorur në mënyrë të përsëritur forcën dhe është i prirur ta bëjë sërish, nëse nuk has një rezistencë të fortë. Edhe nëse është e mundur që kjo hipotezë në fund të rezultojë e vlefshme, është tejet e papërgjegjshme mospërgatitja e një Plani B.

Ekzistojnë dy kundërargumenta që janë më pak të dukshëm, por edhe më të rëndësishëm. Së pari, autoritetet perëndimorë e kanë injoruar rëndësinë e asaj që unë e quaj “Ukraina e re”, e cila lindi me rezistencën e suksesshme të Maidanit. Shumë zyrtarë që kanë një histori marrëdhëniesh me Ukrainën kanë vështirësi

në përshtatjen me ndryshimet revolucionarë që kanë ndodhur atje. Marrëveshja e Asociimit me BE që u firmos kohët e fundit, është negociuar fillimisht me qeverinë e Yanukovichit. Ky udhërrëfyes i detajuar ka nevojë të përshtatet për një situatë tërësisht të re. Për shembull, udhërrëfyesi kërkon zëvendësimin gradual dhe rritimin e gjyqësorit për një periudhë prej pesë vitesh, ndërkohë që publiku po bën thirrje për një rinovim të menjëhershëm dhe radikal. Siç e thotë kryebashkiaku i ri i Kievit, Vitali Klitschko: “Nëse vendos kastravecë të freskët në një enë me turshi, edhe ata shumë shpejt do të bëhen turshi”.

Ndryshe nga sa thuhet në disa rrëfime që qarkullojnë dendur, rezistenca në sheshin Maidan u udhëhoq prej ajkës së shoqërisë civile: të rinj, shumë prej të cilëve kishin studiuar jashtë vendit dhe kishin refuzuar t’i bashkoheshin qoftë qeverisë, qoftë biznesit pas rikthimit të tyre, për arsye se i konsideronin të dy të neveritshëm. (Nacionalistët dhe antisemitët përbënin vetëm një pakicë në protestat kundër Yanukovichit). Ata janë udhëheqësit e Ukrainës së re dhe janë të vendosur kundër “Ukrainës së vjetër”, me korrupsionin e saj të shfrenuar dhe qeverisjen e paaftë.

Ukraina e re duhet të përballet me agresionin rus, rezistencën burokratike brenda dhe jashtë vendit, dhe konfuzionin në popullsinë e saj. Cuditërisht, ajo ka mbështetjen e shumë oligarkëve, i pari ndër ta presidenti Poroshenko, si dhe popullsisë në përgjithësi. Sigurisht, ka ndryshime të thellë në historinë, gjuhën dhe pamjen mes pjesëve lindore dhe perëndimore të vendit, por Ukraina është më e bashkuar dhe më europiane në mentalitet, se kurrë më parë. Megjithatë, ky unitet është tejet i brishtë.

Ukraina e re ka mbetur kryesisht e panjohur sepse është dashur kohë për të bërë të ndihet ndikimi i saj. Ajo nuk kishte praktikisht forca sigurie në dispozicion, atëherë kur lindi. Forcat e sigurisë në Ukrainën e vjetër ishin të angazhuara në shtypjen e rebelimit të Maidanit dhe ato ishin të çorientuara këtë verë, kur iu desh të merrnin urdhëra nga një qeveri e formuar prej mbështetësve të rebelimit. Prandaj dhe qeveria e re pati vështirësi në fillim që të krijonte një rezistencë të fortë ndaj krijimit të enklavave separatiste në Ukrainën lindore. Madje është e habitshme që presidenti Poroshenko ishte në gjendje të organizonte një sulm, vetëm pak muaj pas zgjedhjes së tij, që rrezikoi të ririkthejë ato enklava.

Për të vlerësuar meritat e Ukrainës së re, duhet të kesh patur pak përvojë personale me të. Unë mund të flas nga përvoja ime personale, ndonëse më duhet të rrëfej se jam pak i anshëm në favor të saj. Unë krijova një fondacion në Ukrainë në vitin 1990, që përpara se kjo të bëhej e pavarur. Bordi dhe stafi janë të përbërë tërësisht nga ukrainas dhe ai ka rrënjë të thella në shoqërinë civile. E kam vizituar shpesh këtë vend, sidomos në vitet e parë, por jo që nga viti 2004 deri në vitin 2014, atëherë kur u ktheva të bëhem dëshmitar i lindjes së Ukrainës së re.

Mbeta menjëherë i impresionuar prej përmirësimit të madh në pjekuri dhe ekspertizë gjatë kësaj periudhe, si në fondacionin tim, ashtu edhe në shoqërinë civile në përgjithësi. Aktualisht, angazhimi civil dhe politik është ndoshta më i lartë se kudo tjetër në Europë. Njerëzit kanë provuar gatishmërinë e tyre për të sakrifikuar edhe jetën për vendin. Këto janë forcat e fshehura të Ukrainës së re, që nuk janë vënë re prej Perëndimit.

Mangësia tjetër e qasjes aktuale të Europës ndaj Ukrainës është se ajo nuk arrin të pranojë që sulmi rus ndaj Ukrainës është një sulm indirekt ndaj Bashkimit European dhe parimeve të tij të qeverisjes. Duhet të jetë evidente që nuk është e përshtatshme për një vend, apo një grup vendesh, që janë në luftë, të ndjekin një politikë fiskale kursimi siç po vazhdon të bëjë Bashkimi European. Të gjithë burimet e disponueshëm duhen vënë në punë në përpjekjen e luftës, edhe nëse kjo kërkon shtim të defiçiteve buxhetorë. Brishtësia e Ukrainës së re e bën paqartësinë e Perëndimit edhe më të rrezikshme. Jo vetëm mbijetesa e Ukrainës së re, por edhe e ardhmja e NATO-s dhe Bashkimit European janë në rrezik. Në mun-

gesë të një rezistence të unifikuar është jorealiste të presësh që Putini të ndalë shtytjen përtej Ukrainës, ndërkohë që ai nuhat përçarjen e Europës dhe dominimin prej Ruisisë.

Pasi kam identifikuar disa prej mangësive të qasjes aktuale, do të përpiqem të parashtoj kursin që duhet të ndjekë Europa. Sanksionet kundër Ruisisë janë të domosdoshme, por ato janë një e keqe e domosdoshme. Ato kanë një efekt depresiv jo vetëm mbi Rusinë, por edhe mbi ekonomitë europiane, përfshirë edhe Gjermaninë. Kjo i përkeqëson forcat recesioniste dhe deflacioniste që tashmë janë vënë në lëvizje. Në të kundërt, asistencë për Ukrainën, që kjo të mbrohet prej agresionit rus, do të kishte një efekt stimulues jo vetëm mbi Ukrainën, por edhe mbi Europën. Ky është parimi që duhet të udhëheqë asistencën e Europës për Ukrainën.

Gjermania, si avokati kryesor i rreptësisë fiskale, duhet që të kuptojë kontradiktën e brendshme. Kancelarja Angela Merkel është sjellë si një europiane e vërtetë sa i përket rrezikut që paraqet Rusia. Ajo ka qenë avokati kryesor i sanksioneve ndaj Ruisisë, dhe ka qenë më e gatshme të mos përfillë opinionin publik gjerman dhe interesat e biznesit në këtë rast, se sa në çdo çështje tjetër. Vetëm kur u rrëzua avioni i Malaysian Airlines në korrik, publiku gjerman mbërriti në një gjatësi vale me të. Megjithatë, në lidhje me rreptësinë fiskale, kohët e fundit ajo ka ripohuar besnikërinë ndaj ortodoksisë së Bundesbank-ut – ndoshta si reagim pas përparimit elektoral të forcës “Alternativa për Gjermaninë”, e cila është një parti me program anti Europë. Duket se Merkel nuk e kupton sa shumë i mungon vazhdimësia kësaj rruge. Ajo duhet të jetë e përkushtuar për të ndihmuar Ukrainën, madje edhe më shumë nga sa është për të vendosur sanksione ndaj Ruisisë.

Ukraina e re ka vullnetin politik edhe të mbrojë Europën kundër agresionit rus, edhe të angazhohet në reforma strukturore radikale. Për të ruajtur dhe forcuar këtë vullnet, Ukraina ka nevojë të marrë asistencën e duhur prej mbështetësve të saj. Pa këtë, rezultatet do të ishin zhgënjyesh dhe shpresa do të shndërrohej në dëshpërim. Zhgënjimi u ndie tashmë kur Ukraina pësoi një humbje ushtarake dhe nuk mori armët që i nevojiteshin për t’u vetëmbrojtur.

Është koha që anëtarët e Bashkimit Europian të zgjohen dhe të sillen si vende që janë indirekt në luftë. Atyre u intereson më shumë që të ndihmojnë Ukrainën të vetëmbrohet, se sa t’u duhet të luftojnë për vetveten. Në një mënyrë apo një tjetër, kontradikta e brendshme mes të qënurit në luftë dhe të mbeturit të përkushtuar për rreptësinë fiskale duhet të eliminohet. Atje ku ka vullnet, ka edhe zgjidhje.

Më lejoni të jem më specifik. Në raportin e fundit të progresit që doli në shtator, FMN parashikonte se në skenarin më të keq të mundshëm, Ukrainës do i nevojitet një ndihmë shtesë prej 19 miliardë dollarësh. Që atëherë, gjendja është përkeqësuar. Pas zgjedhjeve në Ukrainë, FMN-së do i duhet të rivlerësojë parashikimin që ka bërë, duke u konsultuar edhe me qeverinë ukrainase. Duhet të ofrojë një injeksion të menjëhershëm në para prej të paktën 20 miliardë dollarësh, bashkë me premtimin për të ofruar më shumë nëse do të nevojitet. Partnerët e Ukrainës duhet të ofrojnë financime shtesë, me kusht zbatimin e programit të mbështetur nga FMN.

Shpenzimi i fondeve të marrë hua kontrollohet prej marrëveshjes mes FMN dhe qeverisë ukrainase. 4 miliardë dollarë do të shkonin për të kompensuar mungesën në pagesat e derisotme të Ukrainës; 2 miliardë do të duhej të shkonin për restaurimin e minierave të qymyrit që kanë mbetur nën kontrollin e qeverisë qendrore; dhe 2 miliardë duhet të shkojnë për blerjen e gazit për muajt e dimrit. Pjesa tjetër duhet të plotësojë rezervat e valutës në bakën qendrore.

Asistencë e re do të përfshinte një shkëmbim borxhi që do të transformonte borxhin e Eurobonove të Ukrainës (në një total prej 18 miliardë dollarë), në bono afatgjata me më pak risk. Kjo gjë do të lehtësonte barrën e borxhit për Ukrainën.

Duke marrë pjesë në këtë shkëmbim, mbajtësit e bonove do të binin dakord të pranonin një normë më të ulët interesi dhe do të prisnin më gjatë për të rimarrë mbrapsht paratë e tyre. Shkëmbimi do të ishte i vullnetshëm dhe i bazuar mbi tregun, me qëllim që të mos ngatërrohej me një falimentim. Mbajtësit e bonove do të ishin të gatshëm të merrnin pjesë, sepse bonot e reja afatgjata do të garantoheshin prej SHBA ose Europës – ndonëse vetëm pjesërisht – pak a shumë ashtu sikurse SHBA ndihmoi Amerikën Latine të dilte nga kriza e borxhit në vitet 1980, me të ashtuquajturat bonot Brady (morën emrin e Sekretarit të Thesarit të SHBA, Nicholas Brady).

Një shkëmbim i tillë do të kishte disa përfitime të rëndësishëm. Njëri është që, përgjatë dy apo tre viteve të ardhshëm shumë kritikë, qeveria mund të përdorë më pak prej rezervave të veta të pakëta të valutës për të paguar mbajtësit e bonove. Paratë mund të përdoren për nevoja të tjera urgjente.

Duke shkurtuar pagesat për borxhin nga Ukraina gjatë viteve të ardhshëm, shkëmbimi do të reduktonte edhe shanset për një falimentim sa u përket borxheve sovranë, duke mos lejuar kështu largimin e kapitalit dhe ndalur rendjen drejt bankave. Kjo do ta bënte më të lehtë për të bindur pronarët e bankave në Ukrainë që të injektojnë brenda tyre kapitale të rinj, të cilët nvojiten me urgjencë.

Në fund, Ukraina do i mbante mbajtësit e bonove të angazhuar në vend që t'i shihte të merrnin cash 100 cent-ë për dollar, teksa në vitet e ardhshëm afrohet afati i pagimit të tyre. Kjo do e bënte më të lehtë për Ukrainën që të rifutet në tregjet ndërkombëtarë të bonove, pasi të ketë kaluar kriza. Në kushtet aktualë, do të ishte më praktike për SHBA dhe Europën që të mos përdornin kreditë e tyre direkt për garantimin e borxhit të Ukrainës, por të përdorin ndërmjetës si BERZH apo Banka Botërore dhe nëndegët e saj.

Kompania shtetërore ukrainase e gazit, Naftogaz është një gropë e madhe e zezë në buxhet si dhe një burim i madh korrupsioni. Naftogaz u shet aktualisht familjeve gaz me 47 dollarë për një trilion metër kub (TCM), për të cilin paguan 380 dollarë për TCM. Për momentin, njerëzit nuk mundin të kontrollojnë temperaturën në apartamentet e tyre. Një ristrukturim radikal i të gjithë sistemit të Naftogazit mund të reduktonte konsumin e familjarëve dhe ndoshta do të eliminoonte totalisht varësinë e Ukrainës nga gazi rus. Kjo do të kërkonte edhe zbatimin e çmimeve të tregut për gazin, për familjarët. Hapi i parë do të ishte vendosja e matësve në apartamente dhe i dyti vendosja e një subvencionit për familjet në nevojë.

Vullneti për të realizuar këto reforma është i fortë edhe në drejtusit e rinj edhe në qeverinë që do të vijë por detyra është tejet e ndërlikuar (si mund të përcaktosh kush është në nevojë?) dhe ekspertiza e pamjaftueshme. Banka Botërore dhe degët e saj mund të sponsorizojnë një ekip zhvillimi projektësh që do të bashkonte ekspertë ndërkombëtarë dhe vendas për të konvertuar vullnetin politik ekzistues në projekte të suksesshëm. Kostoja fillestare do i kalonte 10 miliardë dollarët, por do të finançohej prej bonove për projekte të lëshuara nga Banka Europiane e Investimeve.

Gjithashtu, është koha që Bashkimi European të hedhë një vështrim kritik nga vetvetja. Duhet të ketë diçka që nuk shkon në BE, përderisa Rusia e Putinit është kaq e suksesshme, edhe në terma kohëshkurtër. Burokracia e BE nuk ka më monopolin e pushtetit dhe ajo ka shumë pak arsye për të qenë krenare. Duhet të mësojë të jetë më e bashkuar, fleksibël dhe efiçente. Dhe vetë europianët duhet të shohin më nga afër Ukrainën e re. Kjo do i ndihmonte të rroknin frymën që mbizotëronte atëherë kur krijohej Bashkimi European. Duke shpëtuar Ukrainën, Bashkimi European do të shpëtonte vetveten. /New York Review of Books/
Pergatiti ne shqip: Ermal Gjinaj, www.bota.al



A mund të jetohet në një botë pa atdhe?

Ernst Nolte

E hamendësueshmja «ne» e një njerëzimit të bashkuar, por dhe për shumë kohë akoma konfliktual, nuk mund të zëvendësojë «në»-në e një patriotizmi shpirtmadh si dashuri për një atdhe të kufizuar dhe të shënuar nga një kulturë specifike – përveç se në rastin në të cilin një rrezik i madh vjen nga kozmosi apo pasoja të rënda dhe jo të qëllimshme të të vepruarit njerëzor kërcënojnë ekzistencën njerëzore në tërësinë e saj. Nëqoftëse kjo e ardhme e njerëzimit do të përkthehet në një shpëtim apo në një shkatërrim, është një çështje së cilës mund t'i jepet përgjigjia me një farë saktësie vetëm pas shumë kohësh

Në konceptet e «atdheut» të gjuhëve latine, në gjermanike fatherland e Vaterland apo në sllavisht otjestschestwo shprehet, siç ndodh në konceptin e «gjuhës mëmë» (apo në irlandisht mutterland), domethënia themelore që raporti i derivacionit breznor ka për njerëzit. Por «atdhe» apo Vaterland ka nënkuptuar gjith-

monë diçka më shumë se «familje» e thjeshtë. Realiteti më elementar i një «toke baballarësh» është klani, i cili drejtohet nga një «patriark» dhe që pranë nomadëve nuk ka nevojë për ndonjë raport me një vend specifik dhe që nuk është gjë tjetër përveçse një komunitet kushërinjsh të brezëve të ndryshme, jeta e të cilëve vërtitet rreth tij. Por qysh në epoka shumë të vjetra dhe më pas pothuajse kudo hynë në lojë vendi dhe, sëbashku me të, toka. Klani bëhet një «komunitet fshati», që përfshin në vetëvete edhe individë jo me lidhje fisnore. Në procesin e një zgjerimi të parë hapësinor lindin më pas «qytete» dhe «principata», por kryesori vazhdon të jetë babai i popullit të tij dhe, si në qytete, zgjerimit në hapësirë i pason ai në kohë: e kaluara bëhet e gjallë në gojëdhënat e në mitet, por edhe e ardhmja merret në konsideratë, të paktën si preokupim për t'u mbrojtur nga rreziqet. Por mbi të gjitha sqarohet raporti me botën në tërësinë e saj, me kozmosin, me «zotat» që dominojnë botën dhe mund të flitet kështu për një «shenjtërim» të qytetit të lindjes apo të territorit ku ke lindur. Në qytet – shtetet antike (poleis-et) shfaqet për herë të parë në histori një patriotizëm i plotë forcash jetike dhe vargu i Horacit dulce et decorum est pro patria mori mendohej akoma disa dhjetëvjeçarë më parë të ngrihej si paralajmërim apo të luftohej ashpërsisht, përpara se të futej përfundimisht në letërsi. Hyjneshes Athina i dedikohej çdo vit festimi i «Panatenee»-ve dhe Sokrati, sipër përshkrimit të Platonit tek «Apologjia», refuzoi që të ikte nga burgu sepse donte të vdiste në qytetin e baballarëve saktësisht ashtu pse për të kish jetuar. Ciceroni që vetëm një midis atyre që në mënyrë eksplicite apo sipas ndjenjës përdorën konceptin e amor patriae. Perandoria Romake që një mbretëri planetare e formuar nga atdhera dhe, kur në periudhën e saj të fundit të gjithë banorëve të saj ju dha e drejta e qytetarisë, nuk flitej për një amor imperii, por individ i veçantë, siç kish bërë dikur Apostulli Pal, quhej civis romanus. Pavarësisht kësaj, krenaria për qytetin e baballarëve dhe për zotat e tij nuk që fjala e fundit. Ai zgjerim i parë perandorak gjeti një vazhdim të pakalueshëm në «kozmpolitizmin» e shkollës filozofike stoike dhe në konceptin kristian të patria caelestis, që i privonte të gjitha atdherat konkretë, domethënë të gjitha atdherat materialë, nga autonomia dhe pavarësia e tyre. Ama jo vetëm kristianizmi, por edhe të gjitha fetë e tjera të botës linin të kuptohej se qyteti i baballarëve apo rajoni i lindjes nuk ishte as i «shenjtë», as autonom, por se njeriu është një qenie universale që krijon raport me një Zot të vetëm dhe me një kozmos të vetëm. Në Mesjetën kristiane kjo fe ishte e natyrshme, por, pavarësisht kësaj, koncepti i një atdheu material nuk humbi. Vendlindjet vazhdonin të quheshin «atdhera», si për shembull në shprehjen la Bourgogne est ma patrie. Edhe kur u formuan shtetet kombëtare të Anglisë dhe të Francës, mbeti e gjallë ideja e afinitetit fizik, sepse Mbreti shikohej si babai i vendit, siç e gjejmë të formuluar për shembull në një seksion të Enciklopedisë së vitit 1785: «Një Mbret është kreu i një vendi dhe babai i popullit». Por qysh në Iluminizmin e parë bëri rrugë ideja e lirisë individuale, aq sa Volteri mundi të shkruante: «Ka një atdhe nën një Mbret të mirë; nuk ka asnjë nën një Mbret të keq». Dhe polemika e Monteskjës kundër despotizmit lindor tregonte në mënyrë të paekuivokueshme armiqtësinë kundër absolutizmit në vendin e tij. Shprehja e Shatóbrianit «kur liria zhduket, mbetet një vend, por nuk ekziston më një atdhe», mund të ishte shkruar edhe nga mesi i Gjashtëqindës.

Por këtij «liberalizimi» mund t'i kundërvijet tani një «rishenjtërim», që autorë si Ruzhë de l'Il, poeti i Marsejës, himn i ardhshëm kombëtar francez, e shikonin ngushtësisht i lidhur me konceptin e lirisë: «Dashuri e shenjtë për atdheun (...) liri, e dashur liri». Pak gjëra e karakterizojmë Revolucionin Francez sa kundërvënja midis «mbretëri» dhe «komb», domethënë atdhe. Në shkrimin e tij mbi «shtetin e tretë», Siejè, qysh përpara marrjes së Bastijës, e ndante dukshëm si mbretërinë, ashtu dhe aristokracinë, të cilën e konsideronte të huaj, domethënë derivuese nga frankët gjermanikë, nga «kombi». Për pasojë, revolucionarët «bor-

gjezë» mund të quheshin patriotë, aq sa në Francë për dekada me radhë termat «patriotizëm» dhe nacionalizëm mbetën koncepte republikane, domethënë të majta. Zhozef dë Mestrë drejtoi kështu një betejë të kotë mbrojtëse, kur shkruante në kuptimin tradicional: «Po çfarë është një komb? (...) Është sovrani dhe aristokracia». Por fisnikëria e bërë parti mund të shtinte në dorë, nga mesi i Tetëqindës, konceptin komb dhe atë patriotizëm të ndarë nga ai i mbretërisë, sepse pasuesit e nacionalistëve jakobinë qenë bërë në pjesën më të madhe «internacionalistë»; ndërsa në Gjermani një «parti patriotësh» bavareze i kundërvihet nga viti 1866 në mënyrën më të zjarrtë konceptit të bashkimit të Bismarkut. As patriotizmi shumë i vjetër i klanit, megjithëse thellësisht i transformuar, ishte zhdukur, ndërsa patriotizmit kombëtar kudo predominues nga koha e bashkimit të Italisë dhe atij të Gjermanisë i kundërvihet kudo në formën e internacionalizmit (socialist dhe radikal-liberal) kozmopolitizmi i shndërruar në fenomen politik. Megjithatë, edhe konceptet metapolitike të atdheut dhe kombit qëndruan të gjalla, si për shembull në tezën e Viktor Kuzinit, sipas të cilit në filozofi nuk ka atdhe tjetër përveç njerëzimit; ose në bindjen e formuluar qysh nga romakët, sipas të cilës patria est ubicumque bene est. Ky evolucion u përhap në vendet kryesore europiane në mënyra shumë të ndryshme sepse ju zbatua shteteve të ndryshme në epoka shumë të ndryshme dhe pikërisht për këtë është e domosdoshme të vërehet në mënyrë sintetike situata e këtyre vendeve dhe e këtyre shteteve.

Anglia u bë shtet kombëtar përpara dhe vetë Francës, sepse monarkia e saj mundi ta kryejë luftën e 100 vjetëve kundër Francës duke filluar nga bastioni i qëndrueshëm i përbërë nga ishulli i ndarë nga kontinenti dhe vetëdija kombëtare e saj, sidomos më pas, krijoi rrezikun e përfaqësuar nga fuqia në dukje predominuese e «Papizmit» dhe e Spanjës katolike, tentativa e pushtimit e të cilës në vitin 1588 u shpartallua më shumë nga natyra ishullore sesa nga përpjekjet ushtarake, duke u bërë kështu në pjesën më të madhe të saj një vetëdije ndërkombëtare – protestante.

Por rreth të njëjtës periudhë, poeti i madh anglez, Uilliam Shekspir, i dha zë në një rën prej dramave të tij një patriotizmi si të thuash pararrëfyes, duke vënë në buzët e plakut Xhon di Gaunt, Dukë i Lankasterit, pak përpara vdekjes së tij, fjalët e mëposhtëme lidhur me Anglinë: This royal throne of kings, this sceptred isle.... / This other Eden, demi-paradise... / This precious stone set in the silver sea... / This blessed plot, this earth, this realm, this England... / This land of such dear souls, this dear, dear land... (anglisht në origjinal) Nuk bëhet fjalë për një himn ndaj Anglisë të kohës së tij, që Gaunti e akuzon se ka bërë një shameful conquest of herself, megjithatë mund të thuhet se patriotizmi i vetëvetëdijshëm i banorëve të Ishullit ka mbetur deri më sot tipari me karakteristik i jetës angleze, pavarësisht se Anglia masakrohej pothuajse gjithmonë nga luftëra të brendshme. Por as himni falenderues i Shellit ndaj njeriut të së ardhmes, që do të bëhet «i barabartë, pa klasa, pa klane, pa komb», as kritika e fuqishme e Xh.E.Hobsënit, pararendësi kryesor anglez i Leninit, ndaj influencës së madhe të një kapitalizmi ndërkombëtar në pjesën më të madhe të tij hebraik mbi Sitin financiar londinez, nuk mundën të ndryshojnë ndonjë gjë në këtë konceptim. Himnet ndaj Francës dhe patriotizmit të saj qenë më të dëgjua në vendet limitrofe, veçanërisht në Gjermani dhe në Itali, sesa nuk qenë në vetë Francën. Faktikisht, në këta vende liberalët e bindur e dinin se në Francën e revolucionit «miqtë e progresit dhe të lirisë» kishin marrë emrin e «patriotit» dhe admironin unitetin midis kombit, popullit dhe patriotizmit që haset në Francë. Por francezët e dinin më mirë se të tjerët se patriotizmi i jakobinëve kish qenë jashtëzakonisht gjakatar dhe ekspansionist dhe se vazhdonin të ekzistonin «dy Franca»: ajo e «progresistëve» dhe ajo e «reaksonarëve» pjesërisht akoma besnikë ndaj mbretit. Këto dy parti qenë agazhuar në një përplasje të ashpër, nga e cila lindi një figurë kaq e pasur me dritë dhe hije si Perandori Napoleoni i III-të dhe pikërisht, për pasojë, francezët nuk

u çuditën kur në agimin e Nëntëqindës, në kontekstin e aferës Dreyfus, këto dy Franca hynë sërish në konflikt të ashpër, që ishte njëkohësisht një luftë midis dy tipeve të ndryshme të patriotizmit.

Deri në 1870 dhe në pjesë të madhe edhe në vijim, «partia e lëvizjes» ishte sforcuar shumë për t'u diferencuar nga jakobinizmi, duke ruajtur tek përfaqësuesit kryesorë të saj si Gizó dhe Hygó ndjenjën e sigurtë të së drejtës historike, jo sepse nuk i kundërvihej as kozmopolitizmit, domethënë idesë së bashkimit të ardhshëm botëror, as «nacionalizmit» si pranues i kombit të vet dhe i madhështisë së tij, dhe e konsideronte epokën e tashme si një stadium, por jo si moment të thjeshtë kalimi. Ky skenar ndryshoi vetëm me humbjen në luftën franko – gjermane të 1870/71 dhe në mendimin e Renanit dhe Tejnit Franca mori tonet e një vetëverifikimi kritik që cekte nganjëherë një ankim të dëshpëruar për vendin që Revolucioni e kish çuar në dekadencë. «Lidhja e patriotëve» e themeluar më 1880 nga Pol Déruléd nuk ishte progresiste dhe gjithësesi ishte e mbrujtur me idenë e hakmarrjes. «Nacionalizmi integral» i Çarls Morasit shikonte tek kombi një rrezik vdekjeprurës dhe i kundërvihej në mënyrën më intransigjente çdo tendence internacionaliste.

Konceptimi i Moris Barrèsit i «tokës» dhe i të «vdekurve» futi në mënyrë të ashpër një moment arkaik në patriotizmin e nacionalistëve, por patriotizmi i Klemansoit, që në vitin 1918 drejtoi Francën, si anëtare e aleatëve dhe fuqi e asociuar në fitoren ndaj Gjermanisë, nuk ishte më pak autoreferencial dhe mendjengushtë. Pas humbjes së madhe ndaj Gjermanisë Nationalsocialiste në vitin 1940, edhe ata që i përkisnin regjimit të Vishísë donin të ishin «patriotë», por nuk qenë më të mbushur plot me patriotizmin e sigurtë në vetëvete të grande nation, por kënaqeshin me faktin që Franca, e vetëdijshe për dobësinë e saj, do të mund të luante në të ardhmen vetëm një rol dytësor në Europën e bashkuar nga Hitleri.

Italia ishte për Meternikun vetëm «një koncept gjeografik», një përzierje terri-toresh kufitare të pushtuara: Lombardia e pushtuar nga Austria, principata ose mbretëri të pushtuara nga dinasti të huaja apo gjysëm të huaja dhe nga Shteti i Kishës së Papëve romanë. Edhe pse jo në cilësinë e shtetit unitar dhe të mbyllur, Italia luajti në Europë një rol tejet të rëndësishëm gjatë të gjithë Mesjetës dhe në fillimet e epokës moderne dhe Dante mund të quhet me plot të drejtë një patriot italian apo një apologjet i Italisë sa Makiaveli. Por asgjë nuk qe më pak habitëse se fakti që nën shenjën e Revolucionit Francez dhe në shenjat e para të fitoreve të Napoleonit do të hynin në skenë «patriotë» që donin t'i jepnin fund dominimit të huaj dhe shteteve të vogla dinastike, duke siguruar nën mbrojtjen e ushtrive franceze suksese të mëdha, që u bënë përfundimisht evidente vetëm me humbjen e Perandorit. Por edhe në republikën romane dhe në atë napoletane, ata kishin qëndruar larg nga jakobinizmi radikal dhe kishin pranuar vizionin e botës së Xhambatista Vikos, që nuk i refuzonte realitetet dhe identitetet historike në favor të një kozmopolitizmi abstrakt. Më shumë akoma se në Francë, fjala «patriotë» u bë thirrja e betejës e një partie që nuk donte të ishte aspak parti, por pararoja e bashkimit kombëtar. Tek Macini ata gjetën flamurtarin e tyre kryesor ideologjik; tek Garibaldi heroin e tyre më të famshëm; tek Kavuri realizuesin e planeve të tyre dhe tek «Rilindja» emrin e tyre.

Me Rilindjen, liberalizmi i moderuar arriti triumfin politik që nuk kish njohur asnjëherë në Europë dhe ky qe suksesi i gjithë patriotizmit italian mbi patriotizmat antike dhe të rrënjosura të qyteteve dhe të territoreve dhe, jo të fundit, edhe mbi patriotizmin paradoksal të ndjekësve të Papës, që në çastin e fundit kishin gjetur një mbështetës të jashtëzakonshëm në personin e Gjeeneralit francez Lamorisiè, por që nuk qenë në gjendje ta bëjnë «kristianizmin» e gjymtuar një «komb kristian» të vetëm, që do të ishte analogu i «kombit islamik». Felice Orsini, atentati i të cilit ndaj Napoleonit të III-të kish bërë të avanconte procesi i bashkimit më shumë se çdo ngjarje tjetër, i kish transmetuar Perandorit përpara ardhjes

në fron një «mesazh të përmbytur me amor patrio»; Garibaldi ishte plot me «amor di patria» derikur hyri në kontakt me disa aderues në “Giovine Italia”-n e Macininit; mërgimtarët paraardhës të Revolucionit të vitit 1848 kishin gjetur azil dhe «atdheu i tyre» ishte në krahinën e Piemontes, i bërë gjerësisht kushtetues. Për pasojë, pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, Italia që në gjendje të shpëtonte prej tyre me ndihmën e konceptit të «antirilindjes» të trashëgimisë së rëndë të fashizmit, që në fillim kish gjetur mbështetje të gjerë, kur shpalli mbrojtjen e atdheut kundër internacionalizmit të mbështetur nga marksizmi. Domethënë Italia që në gjendje të shpjegonte me arsye të mira sesi nacionalizmi radikal ishte antipatriotik dhe antikombëtar.

Pas fitores së Aleatëve mbi Hitlerin, në Gjermani nuk që e mundëshme diçka e ngjashme me sa ndodhi në Itali. Është e vërtetë se edhe Gjermania, ashtu si Italia, si territor qëndror i Perandorisë së Shenjtë Romake, në Mesjetë dhe në erën e parë moderne nuk që një shtet kombëtar dhe është e vërtetë se dashuria e evidente për atdheun e Valter fon der Fogelvajdes dhe të shumë humanistëve kish mundur të bënte mjaft pak për ta ndryshuar një situatë të tillë, siç pak mundën të bëjnë Danteja dhe Makiaveli në Itali. Megjithatë, zotërinjtë e shteteve territoriale si Bavaria, Vyrtembergu, Hanoveri dhe Prusia qenë gjermanë dhe mbretëria gjithëpërfshirëse e «mbretërve romanë» gjithmonë kish ditur të ngjallte një «patriotizëm perandorak». Por ai patriotizëm që u artikulua, për shembull, nga Baroni Fon Shtajn në epokën napoleonike me fjalët: «Njoh vetëm një atdhe dhe ai quhet Gjermani», ndryshon nga ai italian, sepse që – dhe ndoshta duhej të ishte – si antidinastik, por sidomos antinapoleonik dhe antirevolucionar.

Kështu që nuk që plot me vullnet vetëm për të krijuar unitet kombëtar, por edhe me ndjenjën e vazhdueshme të rrezikut që rrethonte Perandorinë. Kështu që ai që njëkohësisht mbrojtës e agresiv dhe në dramën e në poezitë e Hajnrih Fon Klajstit dhe Ernst Moric Arndtit ky patriotizëm shfaqte aspekte të një vullneti agjësues të dëshpëruar e fanatik. Edhe tek Hëldeklajni mund të diçka nga këto emocione të thella: Jeto këtu sipër, o Atdhe / Dhe mos numëro të vdekurit / Për ty, o i dashur, askush nuk ka rënë tepër. Në luftërat e periudhës së restaurimit dhe bile deri gjatë Revolucionit të vitit 1848, kalorësit e bashkimit gjerman (që duhej të ishte o «gjerman i vogël» o «gjerman i madh», domethënë pa dhe me Austrinë) nuk arritën ta zotërojnë konceptin e «patriotizmit», por ju desh të kryenin edhe një betejë të vështirë kundër «patriotizmit prusian», që i damkoste me shumë përbuzje Deutschtümler-at (të «teutonizuarit» në kuptim përbuzës) si «antipatriotë» dhe e arritën fitoren vetëm kur Bismarku bëri të tijën kauzën e tyre, me qëllim që të siguronte mbijetesën e Prusisë dhe të monarkisë së tij.

Kur në vitin 194 kjo Gjermani plot kontradikta u zhyt në Luftën e Parë Botërore, nuk mundi të hyjë në lojë, sipas modelit të francezëve dhe të anglezëve, domethënë me objektivin e mbrojtjes së qytetërimit kundër barbarive dhe kështu që patriotizmi i saj mundi të marrë vetëm një formë thellësisht emocionale, në të cilën dukej të rishfaqej uniteti i vjetër midis patriotizmit dhe fesë: Atdhe i shenjtë në rrezik, bijtë e tuaj dalin për të të mbrojtur / I rrethuar nga rreziku, Atdhe i shenjtë, shikon, çdo dorë shkëlqen me armë / Shikona ne të gjithë të zjarrtë, djali gatitu midis djemve. Ti duhet të mbesësh, Atdhe, ne kalojmë. Por vetëm dy vjet më vonë një poet tjetër, anarkisti Erik Myhsam, e vendoste atdheun në një kontekst krejtësisht të ndryshëm: Të vrasim siç na kanë urdhëruar, me gjak e dinamit / për atdheun e për kryeqytetin, për Perandorin e për fitimin / Por kur ditët të kenë përfunduar, atëhere do t’u kushtohemi grave e fëmijëve / Atëhere do të shpartallohen kufijtë, do të bjerë pushteti dhe e gjithë bota do të jetë atdhe / dhe e gjithë bota do të jetë e lirë. Në konfliktin midis këtyre dy koncepteve të atdheut totalisht të kundërvëna, domethënë midis nacionalizmit të rishenjtëruar dhe kozmopolitizmit utopist – idiliak, vetëm një prej dy mënyrave të mendimit mund të fitonte dhe ndoshta në një formë të re të intensifikuar, sikur të mos jetë gjetur

ndonjë ndërmjetësim midis dy të kundërtave në dukje të papajtueshme. Në Gjermani, pavarësisht se në formë thellësisht të ndryshme, fitoi mundësia e parë dhe, megjithëse është sipërfaqësore të ia mosnjohësh mbijetesën edhe atij patriotizmi antik emotiv, mund të kontribuojë për të bërë qartësi të citosh fjalët e një kënge, që në historinë gjermane përbëjnë një analogji me epokën napoleoniane: “Zgjohu Gjermani, vdekje Judës! Në armë popull. Në armë popull”.

Pas humbjes katastrofike të një atdheu përballë të cilit njerëz që u quajtën «tradhëtarë të vendit» më 20 korrik 1944 quheshin me goxha të drejtë patriotë pas perëndimit të shtetit kombëtar dhe pas zhdukjes progresive të një vetëdijeje kombëtare, gjermanët, ashtu si italianët, edhe francezët megjithëse në mënyrë të ndryshme, i vendosën shpresat e tyre në bashkimin e Europës dhe në lindjen progresive të një patriotizmi europian që do të përbënte një zonë të lumtur dhe «humane» të ndërmjetme midis patriotizmit të vjetër kombëtar dhe atij «patriotizmi universal» të Tokës së globalizuar që profillohet sipas fatthënieve të superfuqisë amerikane. Projektet në këtë kahje shkojnë nga «Europa e atdheve» e propozuar nga të Goli në «Europën atdhe» të federalistëve. Por kur pas krijimit të një bashkimi pastërtisht të jashtëm, politikanët europianë, nën shtytjen e interesave të shumëfishta dhe për më shumë joeuropiane, janë shtyrë që të mos i pranojnë ata kufij historikë pa të cilat nuk mund të ketë as identitet, as patriotizëm, duke i siguruar një vendi të madh jashtëeuropian në rritje të shpejtë demografike hyrjen në Bashkimin Europian, i kanë paraprirë më shumë se Shtetet e Bashkuara asaj të ardhmeje «pa komb» që kish paralajmëruar Shelli dhe e kanë vrrarë deri në rrënjë mundësinë e një patriotizmi të një lloji të ri. E hipotezueshmja «ne» e një njerëzimit të bashkuar, por dhe për shumë kohë akoma konfliktual, nuk mund të zëvendësojë «në»-në e një patriotizmi shpirtmadh si dashuri për një atdhe të kufizuar dhe të shënuar nga një kulturë specifike – përveç se në rastin në të cilin një rrezik i madh vjen nga kozmosi apo pasoja të rënda dhe jo të qëllimshme të të vepruarit njerëzor kërcënojnë ekzistencën njerëzore në tërësinë e saj. Nëqoftëse kjo e ardhme e njerëzimit do të përkthehet në një shpëtim apo në një shkatërrim, është një çështje së cilës mund t’i jepet përgjigja me një farë saktësie vetëm pas shumë kohësh.

Ernst Nolte është Profesor në Free University të Berlinit



Veset privatë dhe publikë të politikanëve

Efektet e sjelljeve të udhëheqësve shkojnë përtej marrëdhënies me elektoratin. Nga Henriku VIII tek telashet e Berlusconi dhe mospërmbajtjet e Hollande: kostot ekonomike të zgjedhjeve (i) morale. Mbetet të pyesim: përse e bëjnë? Nëse dikush është në kulm të pushtetit dhe suksesit, luan gjithçka për kënaqësinë, përgjigja më e vërtetë është ndoshta mërzi. Ata që kanë komandën mërzi për vdekje, politika është një inerci pa pushim, ashtu si burgu

Gjëja më e çuditshme është që tani François Hollande akuzohet për “impotence”. Jo në atë kuptim, natyrisht, pasi presidenti francez duhet të jetë në kulmin e parabolës së tij prej mashkulli alfa: katër fëmijë me një grua, që e la për një grua më të re, të cilën edhe atë e la për një edhe më të re, dhe çdo herë me atë lloj mashtrimi që vetëm tradhëtarët serialë janë në gjendje ta bëjnë. Por “impotencia”

(pafuqia) është e kundërta e “gjithëpushtetshmërisë” dhe në të gjithë Europën perëndimore nuk ka udhëheqës më pranë gjithëpushtetshmërisë se sa presidenti i republikës franceze, që nga konstitucionalistët quhet një “monark republikan”. E megjithatë, papajtueshmëria e liderit të gjithëpushtetshëm që bëhet i pafuqishëm shkon përsosmërisht me njeriun e vogël që, i veshur me një kostum blu presidencial, përpiket të adoptojë një ton gjatë konferencave të shtypit të thirrura për të folur për fatet e Francës, por që në të vërtetë janë të rëndësishme vetëm prej asaj që do të thonë për Julie Gayet dhe Valerie Trierweiler, me brirë dhe hape gjumir, e mbi të gjitha për ata “pa dhëmbë”, siç i quan privatisht të varfërit presidenti socialist. Hollande shfaqet tashmë vërtetë i pafuqishëm. Nuk mund të bëjë asgjë për të ndalur zbulimet e një gruaje të plagosur dhe mediave që do ta transformojnë imazhin e tij në objekt talljeje. SI pasojë, nuk mund të ndajë funksionin publik nga privatja, Francën nga krevati i tij. E çfarë mbetet, në një rast të tillë, nga një president?

Kjo pyetje u bë në verën e 2011-ës edhe për Silvio Berluskonin, dhe përgjigja dihet: nga kryeministri nuk mbeti asgjë. Por atij nuk iu dha, prej kulturës dashamirëse dhe vetero-feministe lehtësimit i pafuqisë, as edhe kur e shoqja, Veronica i bëri të njëjtin trajtim si Trierweiler. Përkundrazi. Haremi i Berluskonit u quajt më shumë një shfaqje arrogante e një pushteti pa kufi, patriarkal dh ei dhunshëm, që përdor seksin si dëfrim për oborin: “Seksualiteti si protezë e pushtetit dhe pushteti si protezë e seksualitetit”, shkruante Ida Dominijanni. Për “erotizimin e pushtetit” shkruajti edhe filozofi Zizek. Pjesën tjetër e bëri fraza e Ghedinit për “përdoruesin përfundimtar”. Pra, bëhesh pluhur e hi prej pafuqisë, apo prej delirit të gjithëpushtetshmërisë? Dhe kjo kundërshti e sofistikuar nuk është ripozicionimi i radhës i dilemës së lashtë, nëse është më mirë të komandos apo të dështosh. Përgjigja është e mbushur me pasoja, deri edhe ekonomike. Sepse nëse seksi i liderëve jep pafuqi politike, atëherë ai që vuan është kombi. Dhe ky është leksioni vërtetë i madh i kohëve tona.

Privatja e të pushtetshmëve ka bërë gjithmonë histori. Antoni nuk mund të kishte të dyja, edhe Romën, edhe KLeopatrën. Henriku VIII donte t’i kishte të dyja, edhe Kishën, edhe Bolenën. Vetë Rilindja italiane, u lehtësua prej magjepsjes që kontesha e Kastiliones, e manovruar me aftësi prej kushëririt Cavour, ushtroi mbi Napoleonin III (gjithmonë këta francezët). Edhe periudha pas De Gasperit në Itali do të kishte qenë ndryshe, nëse djali i ministrit të Jashtëm, Piccioni, nuk do të kishte përfunduar në procesin për vdekjen e Vilma Montesi, vajza që u gjet pa jetë dhe pa tiranda në bregun e detit në Torvaianica pas një nate orgjie.

Por në të gjitha këto histori mungonte ende përbërësi shpërthyes që e bën sot privaten menjëherë politike: diktatura e opinionit publik. Të pushtetshmit mëkatonin që çke me të, njësoj apo edhe më shumë se sa të sotmit, por 1) pak vetë e dinin dhe 2) askush nuk gjykonte. Vetëm me ardhjen e demokracisë së publikut, që voton përditë përmes sondazheve, sjellja seksuale e atyre që na qeverisin është bërë, përveç se mall konsumi popullor, edhe kriter vlerësimi, matës për seriozitetin, ndershmërinë dhe sinqeritetin. Pra, duket se seksi përmban sot një “aftësi zbuluese për llojin e komandës së politikanit”, ka shkruajtur Ciro Tarantino tek “Dhe mishi u bë fjalë”. Dhe nuk është vetëm faji i vëllait të madh mediatik dhe rrjeteve sociale.

Është fakt që politikanët kanë bërë praktikisht gjithçka që kjo të ndodhte. Në numrin e fundit të “Revista politike”, Mauro Calise flet për Matteo Renzi dhe analizën e tij për “partinë personale dhe dy trupat e liderit”, duke e quajtur atë ku jetojmë, si “shekulli monokratik”. Ilvo Diamanti flet madje për “qeveri personale”. Të dy sinjalizojnë personalizimin e skajshëm të komandës që udhëheqësit e rinj e kanë zgjedhur si mjet komunikimi me publikun, duke e zotëruar deri tek intimitja. Është një proces që në Europë e nisën Tony Blairi dhe Silvio Berlusconi, por që tani është i pakthyeshëm. Kreu politik kërkon që të pranohet dhe gjykohet

për atë që është, jo për partinë që udhëheq apo programin që propozon. Ofron një shkëmbim besimi. Është e pashmangshme pra që një falimentim i personalitetit të shndërrohet në një falimentim politik, dhe që opozitës i mbetet vetëm “vrasja e karakterit”. Një udhëheqës që gënjen të dashurën mund të gënjejë edhe vendin e tij. Një lider që manipulohet prej stimuluesve seksualë për të gjallëruar mbrëmjet, mund të manipulohet edhe kur ndjek interesin kombëtar.

Duhet shtuar që ky gjykatës i ri, opinioni publik, edhe ai vetë i gjithëpushtetshëm, është tashmë global dhe i ndërvarur. Dhe mund të kuptohet përse takspaguasit gjermanë e kanë konsideruar të rëndësishme për fatin e krusimeve të tyre të zbulonin se si i kalonte mbrëmjet kryeministri italian, ndërkohë që Banka Qendrore Europiane hidhte miliarda euro për borxhin publik të Italisë. Berlusconi nuk u rrëzua prej Rubi zemër-rrëmbyeses, por pa Rubyn me siguri do të kishte shmangur atë të qeshurën nën hundë mes Sarkozysë dhe Merkelit. Po kështu, sot Franca e Hollande ka më shumë vështirësi që Europa t'i falë deficitin e saj të tepruar, tani që presidenti i saj është i gjymtuar nga skandali, dhe mbështetja për të është vetëm 13%. Nëse marrëdhëniet mes kombeve që ndajnë kufijtë, monedhën dhe tregjet janë domosdoshmërisht të bazuara në besimin reciprok, atëherë kredibiliteti shndërrohet në një faktor vendimtar. Dhe kredibiliteti i një vendi tashmë varet shumë nga reputacioni personal i liderit të tij.

Të strehuara në sovranitetin kombëtar të dikurshëm, lajthitjet seksuale ishin më të mbrojtura (Mitterrand kishte një familje të dytë dhe një vajzë të paligjshme, por nuk pati pasoja). Në një Europë me sovranitet të kufizuar, standartet anglosaksonë të etikës publike kanë mbizotëruar, bashkë me gjuhën angleze dhe teoritë neoliberale në ekonomi. Edhe në shtrat, Franca nuk gëzon më veçantinë kulturore. Pastaj, është përsëritëse: Hollande është president vetëm sepse Sarkozy i kishte lodhur francezët me historitë e ti me gra dhe Dominique Strauss-Kahn ua kish sjellë në majë të hundës me mënyrën si i kapte gratë.

Mund të projektosh madje edhe një model matematikor, një lloj kurbe të Lafferit për seksin, për të matur pasojat makroekonomike të skandaleve. Do të shihej që ankthi për të rifituar kredibilitetin e humbur zakonisht i shtyn liderët drejt një rrëshkitjeje djathtas, drejt rreptësisë buxhetore dhe politikave të ofertës. Hollande, për shembull, ka shpallur dy kthesa në politikën ekonomike që përkojnë me daljen e problemeve të tija private. I pakti ishte i ashtuquajtur “pakt i stabilitetit”, që premtonte shkurtime në shpenzime publike për të ulur taksat mbi sipërmarrjen. Për socialistin që donte të rikthente Keynesin në Europë, konvertimi në kerkantizëm shkaktoi skandal, por gjithësesi më pak se zbulimet e revistës “Closer” mbi marrëdhënien e tij me Julie Gayet. Herën e dytë ndodhi me largimin e ministrit Montebourg dhe nga krahu i majtë i qeverisë, pikërisht kur po dilte libri-vrasës i Valerie. Nga ana tjetër, edhe skandalet e Berluskonit përsheptuan kthesën drejt rreptësisë fiskale të qeverisë Monti. Pothuajse sikur mëkati duhet të shoqërohet gjithmonë me shlyerjen.

Mbetet pyetja: përse e bëjnë? Nëse dikush është në kulmin e pushtetit dhe të suksesit, luan gjithçka për kënaqësinë, pak a shumë jetëshkurtër, duhet kuptuar përseja. Dhe përgjigja më e vërtetë, ndoshta, është mërzi. Njerëzit me pushtet mërzi të për vdekje. Veprimtaria politike është quajtur me të drejtë një inerci pa pushim: e njëjta shprehje që përdoret zakonisht për shërbimin ushtarak, apo për jetën në burg. Kërkimi për hapësira dëfrimi, në këtë rast, bëhet fiksim. Varësia nga seksi është një sëmundje profesionale e politikanit. /Antonio Polito / Corriere della Sera/

PERSHTATUR NE SHQIP NGA www.bota.al



Të vërtetat dhe gënjeshttrat e “gjithë njerëzve të Presidentit”

SKANDALI WATERGATE / Përtej “Deep Throat”. Burimet e shumtë që rrëzuan një president e që u përdorën nga Bob Woodward dhe Carl Bernstein, për të “shembur” të gjithë njerëzit e presidentit

Bob Woodward dhe Carl Bernstein ishin vetëm dy prej shumë aktorëve në dramën e Watergate-t, dhe ndoshta jo më të rëndësishmit, pavarësisht përpjekjes së Robert Redford për t’i bërë të adhuruar. Watergate do të jetë gjithmonë një prej momenteve më të lavdishëm të mediave. Por si e tregojnë edhe dokumentat e Pakulas, edhe me gjithë burimet anonimë që kishin Woodstein, merita për drejtësinë e dhënë duhet të ndahet me proceset ligjore dhe atë në kongres. Epoka e adhurimit të Woodwardit dhe Bernsteinit duhet të marrë fund

Në vitin 2005, Mark Felt vendosi të bëjë një hap përpara dhe të vetëidentifikohet si burimi sekret më i famshëm në historinë e gazetarisë. Ish drejtuesi tashmë 91 vjeçar i FBI-së pranoi se kish qenë ai “Deep Throat”, burimi anonim, informacioni i të cilit kishte qenë jetik për scoop-et e shumtë në lidhje me skandalin e Watergate, e që u shkruajtën prej gazetarëve të Washington Post, Bob Woodward dhe Carl Bernstein në vitet 1972-1973. Një lojë kombëtare hamendësimesh që ishte luajtur për afro 31 vjet, dukej se tashmë kishte marrë fund.

Megjithatë, zbulimi i Deep Throat krijoi ndërlikime të rinj, siç ka vërejtur studiuesi i mediave, Matt Carlson, në vitin 2010. Felt, i goditur nga një atak, nuk ishte më në gjendje të fliste për veten e tij; në të njëjtën kohë “Woodstein” (siç njihej dyshja e gazetarëve atë kohë tek Washington Post) nuk mund të diktonin me kushtet se çfarë dhe si duhej menduar për Deep Throat. Spekulumet vazhduan, jo vetëm për mënyrën se si Woodward dhe Bernstein kishin përdorur burimet, por edhe për atë që Carlson e quante “saktësia e përgjithshme e rrëfimit të Watergate-t, siç është ritreguar nga gazetarët”, të cilët normalisht kanë interes për një version që i glorifikon ata vetë.

Asgjë nuk ndikoi më shumë për të ushqyer këta dyshime, se sa një biografi e vitit 2012 e Ben Bradlee, redaktori i famshëm i Woodward dhe Bernstein tek The Post. Në librin “Juaji në të vërtetën”, autori Jeff Himmelman, një ish dishepull i Woodwardit, përshkruan se si kishte gjetur një intervistë e cila ishte rregjistruar ndërkohë që Bradlee po përgatiste autobiografinë e tij në fillimin e viteve 1990. Në të, redaktori i Post shprehte dyshime për përshkrimin që Woodstein i kishin bërë Deep Throat-it në librin e tyre investigativ, “Të gjithë njerëzit e Presidentit”. “Më ka mbetur një frikë në shpirt që nuk është dhe aq e vërtetë”, i thoshte Bradlee intervistuesit në vitin 1990. Në letrat e Bradlees, Himmelman kishte gjetur edhe një memo nga Bernstein, ku ai përshkruante takimin e fshehtë në dhjetor 1972 me një burim që e identifikonte vetëm me emrin e koduar “Z”. Tek “Të gjithë njerëzit e Presidentit”, informacioni i ofruar nga “Z” pothuajse barazohej me zbulimet e bërë nga “Deep Throat”.

Himmelman kuptoi “sa bëjnë dy plus dy” dhe kuptoi që “Z” ishte pjesëtar i jurisë së madhe që kishte lëshuar akt-akuzën e parë kundër grabitësve të Watergate në shtator 1972 – ndonëse në librin e tyre, Woodstein mohojnë shprehimisht të kenë marrë informacione nga ndokush në jurinë e madhe. Nuk kish nevojë të ishte skeptik për të besuar që Woodward dhe Bernstein vazhdonin të mos tregonin të vërtetën e plotë për burimet e tyre.

Tani ka dalë një dokument, në një vend të pazakontë, i cili hedh dritën e nevojshme mbi raportimin e Woodstein, ndërkohë që ofron edhe pak perspektivë mbi rolin e shtypit në zbulimin e skandalit.

Është e çuditshme, por dokumenti – një draft i lajmit fillestar të Woodstein i janarit 1973 – u gjet thellë në letrat e Alan J. Pakulas, regjisor i filmit të Hollywoodit me të njëjtin emër, i cili bazohej pikërisht tek best seller-i i Woodsteinit. Pakula, që ndërroi jetë në vitin 1998, ia la të gjithë dokumentat e tij Librarisë Margaret Herrick në Akademinë e Arteve dhe Shkencave – pra, njerëzve që japin Oscar-ët. Koleksioni përfshin kërkimet që ka bërë ai vetë për “Të gjithë njerëzit e Presidentit” dhe në shumë drejtime, dokumentat e Pakulas janë shumë më informues për librin dhe për filmin, se sa dokumentat e vetë Woodwardit dhe Bernsteinit, që mbahen në Qendrën Harry Ransom në Austin, Teksas.

Drafti 15 faqe i artikullit është një udhërrëfyes i paprecedentë për mënyrën se sa dyshja e gazetarëve të Washington Post përdorën shumë burime anonimë që i kishin kultivuar me shumë kujdes. Për arsye që nuk dihen – Woodwardi dhe Bernsteinit kanë refuzuar të komentojnë – gazetarët i zbuluan Pakulas identitetet e disa prej këtyre burimeve të vyer. Emrat janë të shkruajtura në skajet e draftit si dhe janë të renditur në një letër të veçantë.

Njëri prej gjashtë burimeve anonimë është i famshmi “Deep Throat” dhe ai nuk

është një personazh i sajuar, siç kanë thënë shpesh kritikët. Një tjetër është “Z”, juristi. Tre apo katër të tjerët janë surprizë. Ata përfshijnë njërin prej tre prokurorëve fillestarë në ngjarjen e Watergate, një avokat të të akuzuarve që më pas u largua, si dhe një operativ republikan, emri i të cilit është i panjohur ndoshta edhe për ata që kanë dijeni të thella për skandalin e Watergate. Të marrë së bashku dhe të vendosur në kontekst, këta burime zbulojnë jo vetëm anatomicin e vërtetë të lajmit të Woodstein, por edhe një të vërtetë të rëndësishme për raportimin, që i dha “Washington Post”-it Cmimin “Pulitzer” në vitin 1973.

2 Është e rëndësishme të kuptohet historia komplekse e draftit të këtij shkri-mi, përpara se të shkojmë tek burimet anonimë të Woodsteinit dhe si u shfrytëzuan ata.

Për disa muaj, pas futjes me forcë në 17 qershor 1972 në zyrat e Komitetit Kombëtar Demokrat në kompleksin e zyrave të Watergate, të gjitha ato që i ndjeri David Halberstam i quante “fuqitë e medias” e mbuluan këtë krim të pazakontë. Time, Newsweek, Los Angeles Times, New York Times dhe CBS Evening News i kushtuan të gjitha burime të rëndësishëm këtij lajmi, por ata të Washington Post ishin më të paepur. Megjithatë, shtypi nuk po kishte më shumë sukses se sa FBI dhe prokurorët federalë në vërtetimin se dikush në nivele më të lartë se sa shtatë burrat që u kapën “me preshe në duar” ishte i përfshirë në këtë krim, ndonëse tre prej tyre (E. Howard Hunt, G. Gordon Liddy dhe James McCord) kishin punuar drejtpërdrejtë për administratën Nixon ose në aparatit e fushatës së tij elektorale. Edhe për ata amerikanë që ishin të prirur ta merrnin seriozisht këtë krim – dhe të shumtë ishin ata që e injoruan si një marifet fushate – ajo grabitje nuk kishte kuptim. Përse duhej Shtëpia e Bardhë të kërkonte përgjime të paligjshëm, në një kohë kur Nixoni kishte mbështetje aq të lartë në sondazhe? Në çdo rast, ky marifet (nuk ishte ende skandal) nuk po kishte asnjë ndikim për zgjedhjet.

Pas fitores së thellë të Nixonit në nëntor, mbulimi mediatik u tkurr shumë, duke përfshirë edhe Washington Postin. Gazetarët që ishin ende të interesuar për lajmin prisnin që kthesa e radhës do të vinte gjatë gjyqit të shtatë “keqbërësve”, që ishte planifikuar të fillonte në 8 janar. Nëse nuk do të kishte ndonjë dëshmi dramatike në sallën e gjyqit të gjykatësit John J. Sirica, interesi për lajmin do të zhdukej tërësisht.

DIKU nga mesi i ditës së 16-të të gjyqit, u bë e qartë se nuk do të diltë asnjë grimë informacioni i ri. Pesë prej të akuzuarve u shpallën vetë fajtorë që në fillim dhe duke qenë se nuk po mbroheshin, kjo nënkuptonte që nuk ishin të detyruar të ofronin një shpjegim. Ndërkohë, McCord dhe Liddy, që vendosën të vazhdojnë të gjykohen, nuk komunikonin asgjë pasi shpallën pafajësinë e tyre – gjë që ishte veçanërisht e çuditshme në rastin e McCordit, përderisa ky kish qenë mes të shtatëve që ishin kapur “me preshe në duar” brenda zyrave të Partisë Demokratike. Kishte shumë arsye për të besuar që pyetjet më serioze – mbi të gjitha: kush e kishte urdhëruar dhe përse? – do të mbeteshin pa përgjigje. Në mesin e gjyqit, botuesja e Washington Post, Katharine Graham ftoi Woodwardin për drekë, një takim që është përshkruar deri në hollësi tek “Të gjithë njerëzit e Presidentit”, sepse ishte takimi i saj i parë me njërin prej gazetarëve që po bënte që gazeta e saj të ishte e vetme në gjithë këtë histori. Me një zë që zor se ia fshihte frikën, ajo pyeti Woodwardin: “A do të dalë? Dua të them, a do të arrijmë ndonjëherë të dijme gjithçka për këtë skandal?” Woodwardit iu desh të pranojë se ai dhe Bernsteinin nuk ishin të sigurtë nëse misteri i Watergate do të zbulohet ndonjëherë plotësisht. Në 24 janar, një ditë pas Woodwardi dëgjoi Jeb Magruderin të dëshmojë në gjyq – i vetmi zyrtar i fushatës së Nixonit që bënte një gjë të tillë – gazetari i Washington Post sinjalizoi “Deep Throat” se kishte ardhur koha për takimin e tyre të parë të rëndësishëm që nga fundi i tetorit. Tashmë të dëshpëruar se sa pak gjëra po dilnin prej gjyqit, Woodstein kishin vendosur të shkruanin një artikull që do të shtynte përpara gjërat, do të përmendte emra dhe do të nxirrte e zeza mbi të

bardhë disa gjëra që nuk po thuheshin në gjyq – mbi të gjitha që, zyrtarë të niveleve të lartë të administratës dhe fushatës së Nixonit po dilnin pa u lagur. Wat 4 Sipas rrëfimit tek “Të gjithë njerëzit e Presidentit”, takimi atë natë me Feltin ishte shumë irritues. Pavarësisht parodisë së drejtësisë që po shihej në sallën e gjyqit të Siricas, “Deep Throat” po tingëllonte shumë kavalier dhe tmerrësisht i paqartë, duke vazhduar me pozicionin e fillimit, që do u përgjigjej vetëm informacioneve dhe nuk do të ofronte asnjë të tillë. Woodwardi e çoi bisedën tek ish Kryeprokurori, John Mitchell dhe ndihmësi në Shtëpinë e Bardhë, Charles Colson, dy zyrtarë të lartë që i kishin shpëtuar përmendjes në gjyq dhe emrat e të cilëve Woodstein kishin ndërmend t’i fusnin në paragrafin hyrës të artikullit që do të shkruanin.

Felti, sipas shënimeve të Woodwardit, tha se “nuk kishte asgjë që ai do i konsideronte si prova rrethanore që tregonte se Mitchell apo Colsoni ishin të përfshirë. Megjithatë, ishte ndjesia e krerëve të FBI dhe Drejtorit L. Patrick Gray, që Colsoni dhe Mitchell ishin prapa këtij operacioni – sidomos Colsoni, roli i të cilit ishte aktiv. Pozicioni i Mitchellit ishte më shuma ‘amoral’”, kish thënë Felti, pasi “thjeshtë kish pohuar me kokë, por pa marrë pjesë në skemë”. Nëse FBI nuk do të provonte këtë “supozim investigues”, do të thoshte më vonë Deep Throat, atëherë ai nuk mendonte që edhe Washington Post do të mundej ta bënte.

I dëshpëruar për të mos e lënë garazhdin duarbosh, Woodwardi i përshkroi shkrimin e ardhshëm për Mitchellin dhe Colsonin dhe e pyeti direkt Feltin nëse mendonte që Post kishte mbledhur informacion të mjaftueshëm për një artikull. Këtë e vendoste gazeta, i ishte përgjigjur Deep Throat, por Woodwardi kish vënë re që Felti “nuk dukej i habitur prej shkrimit”.

Pasi u këshillua me Bernsteinin – në atë kohë, i vetmi person tjetër që njihte Deep Throat-in, identitetin e tij si dhe pozicionin shumë delikat që ky mbante – Woodwardi vazhdoi përpara, duke e injoruar reagimin e zbehtë të Feltit. Më pas, Bernsteinin e ripunoi tre herë draftin e shkrimit. Paragrafi hyrës u mor direkt prej takimit në garazhd me Feltin, në 24 janar:

“Hetuesit federalë kanë konkluduar se ish Prokurori i Përgjithshëm, John N. Mitchell dhe Charles W. Colson, këshilltar special i Presidentit, të dy kanë patur dijeni të drejtpërdrejtë për operacionin e spiunazhit që u krye prej personave të dënuar në skandalin e Watergate, sipas burimeve të besueshëm”.

“Burimi i besueshëm” më i rëndësishëm në këtë drejtim ishte Deep Throat, por Woodstein përmendën dhe cituan edhe pesë burime të tjerë konfidencialë dhe të paemër, në përpjekjen e tyre për të prodhuar një rrëfim bindës në lidhje me rolet e Mitchell dhe Colson.

Burimi i parë anonim (përveç Feltit) i përmendur në draftin e artikullit ishte dikush “emri i të cilit shfaqej në listën e dëshmitarëve” në gjyqin që vazhdonte. Ky person citohej të kishte thënë se E. Howard Hunt i kishte thënë që “raportet me shkrim të përgjimeve i shkonin Mitchellit” dhe që Colsoni e kishte miratuar futjen fshehtas gjatë natës “për arsye se ai është një operator dhe e kuptonte që këto gjëra janë të domosdoshme”.

Ky burim anonim, sipas orientimit që ka ofruar Pakula, ishte Robert F. Bennett, atëherë pronar i Robert R. Mullen Co., një kompani elitare marrëdhëniesh publike në Uashington. Hunti kishte punuar me kohë të pjesshme tek Mullen ndërkohë që punonte edhe për “hidraulikët” e Shtëpisë së Bardhë, nofka që u ishte vënë pjesëtarëve të një njësie sekrete e cila hetonte nxjerrjet e informacioneve sekretë.

Që Bennett (i cili më vonë u zgjodh Senator i Utah) kish qenë një burim i fshehtë i Woodsteinit, këtë gjë e kemi ditur prej kohësh. Dëgjesat shumë më pak të njohura në Kongres në lidhje me Watergate përmbajnë edhe një memo të CIA-s të vitit 1973, ku zbulohet se Bennett “ka furnizuar me informacione Bob Woodwardin e The Washington Postit, por kanë rënë dakord që ai të mos përmendet.

Woodwardi është mirënjohës për informacionet që merr dhe ai e mbron Bennet-tin (dhe kompaninë Mullen)”.

Një burim i dytë anonim, i përshkruar si dikush që “i njuh katër të akuzuarit nga Miami” përmendet në draftin e artikullit për t’i dhënë më shumë besueshmëri asaj që Hunti u kish thënë të akuzuarve se “operacioni i përgjimit ishte për Mitchellin dhe që Hunti vetë i kishte raportuar Colsonit”.

Ky burim identifikohet në skaje të letrave si “Roth”, ose Henry B. Rothblatt, i cili fillimisht kishte qenë avokati i katër të akuzuarve të Miamit që u arrestuan në zyrat e Watergate.

Parë në retrospektivë, bashkëpunimi i Rothblatt me Woodsteinin nuk ishte aq i çuditshëm, pasi avokatët mbrojtës përpiqen shpesh herë të mbrojnë çështjen e tyre edhe në opinionin publik. Por më e rëndësishmja, tashmë Rothblatt ishte ish avokat i të akuzuarve të Miamit. Ata e kishin larguar disa javë më parë, me arsyen se ai kishte refuzuar të ndryshonte deklaratën e tyre nga të pafajshëm, në fajtorë. Rothblatti, i cili ndërroi jetë në vitin 1985, më vonë do të deklaronte se të katërt ishin nxitur të ndryshonin deklaratimet e tyre, dhe më pas shërbeu si dëshmitar i Prokurorisë gjatë gjyqit të atyre që u akuzuan për mbulim të skandalit të Watergate.

Burimi tjetër anonim i përmendur në draft – që përshkruhet si dikush “i njohur me hetimin federal” – citohet të ketë thënë se Mitchell dhe Colsoni “merrnin informacione për atë që përftohej nga përgjimet”. Woodstein zbuluan se ky burim ishte “EE”, inicialet e Elayne Edlund, pjesëtarja e jurisë së madhe të Watergate, që ishte intervistuar në fshehtësi nga Bernsteini në dhjetor.

Identiteti i Edlundit duhej që të ruhej po aq shumë sa ai i Feltit. Kjo sepse juristët bëjnë një betim për të mbajtur të fshehtë dëshminë që jepet para tyre. Tek “Të gjithë njerëzit e presidentit”, Woodstein e errësuan qëllimisht faktin që “Z” ishte një jurist/e, duke pretenduar që ajo ishte një burim i zakonshëm ndërkohë që pohonin se “nuk kishin marrë informacion nga ndonjë prej pjesëtarëve të gjykatës”. Roli i saj i vërtetë u bë i njohur vetëm në vitin 2012, kur Jeff Himmelman gjeti memon e intervistës së Bernsteinit në dokumentat e Bradlees. Edhe atëherë, Himmelmani u kujdes të mos e përmendë Edlundin, duke mos e ditur që ajo kishte ndërruar jetë në vitin 1991.

Në këtë pikë të draftit, Woodsteini iu kthyen sërish “Deep Throat”-it – i përshkruar si dikush që “ka njohuri për hetimin e FBI-së” – për të përsëritur para grafën kryesor: “pra që informacionet në dosjet e FBI tregojnë se ‘Mitchelli ishte i përfshirë dhe kishte njohuri’” në lidhje me futjen natën në zyrat e PD, por që ende kishte një “debat thelbësor” brenda FBI në lidhje me përfshirjen e Mitchellit dhe “nëse ai kish bërë ndonjë gjë të paligjshme”.

wat 6Felti/Deep Throat-i identifikohet si “njeriu i Bobyt” ose “miku” për Pakulën. Kështu që, Felti ishte burimi i vetëm identiteti i të cilit iu mbajt i fshehtë regjisorit të filmit.

Burimi i katërt anonim që u përdor përshkruhet në draft si “njëri prej atij grushti njerëzish që kishin njohuri të plota për faktet në këtë çështje”. Ky burim citohet të ketë thënë se “një pjesë e madhe e hetimit federal është përqëndruar tek Colsoni”, i cili njihet si njeriu më i afërt i Nixonit dhe nëse do të akuzohej një person i tetë, “me siguri ky do të kish qenë Colsoni”.

Ky burim, i identifikuar në skaje si “Glan”, dhe në një letër tjetër si “Glanzer”, ishte sigurisht Seymour Glanzer, një prej tre prokurorëve të çështjes fillestare ndaj të shtatëve.

Dihet mirë që prokurorët i provojnë kauzat e tyre në media dhe para ose mbrapa i provojnë në sallën e gjyqit. Por deri tani, nuk ishte ditur (ndonëse shumëkush dyshonte) se një prej prokurorëve të Watergate rridhte informacione për Woodstein. Glanzer, thotë një koleg, do të mohonte me forcë që të ketë bërë deklaratatë tilla për dyshen e Washington Postit, dhe ka arsye për të besuar që ata i kanë

“zgjatur” disi fjalët e tij.

Burimi i fundit anonim që kanë përdorur Woodstein nuk është lidhur asnjëherë me gazetaret. Edhe për personat që dinë hollësi për Watergate-n, emri i tij do të vijë si surprizë. Emri i tij përmendet në draft si “një zyrtar i Shtëpisë së Bardhë që dëshiron të mbetet anonim”, dhe në shkrim citohet të ketë thënë se “përgjithësisht ishte kuptuar që Hunt po punonte për projekte sekrete për Colsonin, që kishin të bënin me rizgjedhjen e presidentit”.

Emri “Flemming” shfaqet me shkrim dore në skaje dhe “Flemming”-u është vendosur në një copë letër të veçantë. Sipas ish këshilltarit të Shtëpisë së Bardhë, John Dean, kjo do të thotë që ky person ishte Harry S. Fleming. Babai i tij, Arthur S. Fleming kish qenë Sekretar për Shëndetësinë, Arsimin dhe Mirëqenien në administratën e Dwight Eisenhowerit nga viti 1958 deri në vitin 1961. Por profili i Harryt ishte shumë më i ulët. Gjatë fushatës së Nixonit në vitin 1968, ai ishte ndërlidhësi mes fushatës dhe Komitetit Kombëtar Republikan. Pas zgjedhjes, ai iu bashkua stafit të Shtëpisë së Bardhë si ndihmës special i personelit presidencial. Gjatë fushatës së vitit 1972 Fleming, i cili ndërroi jetë në vitin 2003, punoi me kohë të pjeshme në ekipin e fushatës dhe ai njihje shumë prej aktorëve kryesorë të Watergate. Megjithatë, si zyrtar i nivelit të dytë, ai nuk merre pjesë në takime ku tema ishte “survejimi elektronik”, dhe dijenitë e tij ishin përgjithësisht të dorës së dytë.

Skandali më i madh

Përse Pakula, një regjisor që në Hollywood njihej si perfeksionist dhe që bënte kërkime të thellë për filmat e tij, ishte kaq i intriguar prej këtij artikulli, nga dhjetëra që kishin shkruajtur Woodstein gjatë vjeshtës dhe dimrit të 1972-1973-shit? Përse Woodstein jo vetëm i treguan regjisorit draftin e parë, por edhe ndanë me të identitetet e të gjithë burimeve konfidencialë, përveç njërit? Ironikisht, të gjithë këto ndodhën sepse drafti fillestar i artikullit nuk u botua asnjëherë tek The Washington Post.

Siç tregohet tek “Të gjithë njerëzit e Presidentit”, drafti “prodhoi mosmarrëveshjen më të madhe mes Bernsteinit dhe Woodwardit që kur këta kishin filluar të bashkëpunonin shtatë muaj më herët”. Pavarësisht se sa herë e kishte shkruajtur Bernsteini artikullin në makinën e tij të shkrimit, Woodwardi shprehte rezerva duke thënë se “nuk mendonte që duhej ta botonin, deri kur të kishin prova të mëtejshme”.

Dyshimet e Woodwardit buronin ndoshta prej reagimit të zbehtë të Deep Throat dhe komentit të tij që nuk kish gjasa që The Washington Post t’i kishte sukses, aty ku FBI kishte dështuar. Po kështu, dy apo tre shkrime më herët në lidhje me Watergate-n, Woodstein kishte bërë gabimin e dëmshëm në një lajm, në lidhje me Shefin e Kabinetit të Shtëpisë së Bardhë, H. R. “Bob” Haldeman. Shtëpia e Bardhë e kishte shfrytëzuar këtë gabim për të kundërsulmuar, dhe hija që ai lëshoi mbi shkrimet e Woodstein e kish bërë dyshen të mendonte se ndoshta duhej edhe të largoheshin nga gazeta.

Bernsteini nuk kishte rezerva, duke argumentuar se Washington Post nuk kish përse të ofronte prova përfundimtare. Lajmi ishte për atë që “mendonin” hetuesit dhe jo atë që tregonin provat, dhe mbi këtë arsyezim, drafti meritonte të botohej. Debati mes dy gazetarëve u nxeh aq shumë, saqë në më shumë se një rast ata u larguan nga redaksia, për në korridore, aty ku mund t’i ulërinin njëri-tjetrit.

Partneriteti i tyre nuk kish qenë kurrë kaq pranë fundit. Bernsteini akuzoi Woodwardin se po bënte lojën e Shtëpisë së Bardhë, ndërkohë që Woodwardi akuzoi Bernsteinin se po përpiqej të botonte një shkrim që do të shkaktonte një tjetër sulm, edhe më të dëmshëm, ndaj Washington Postit nga Sekretari i Shtypit i Nixonit, Ron Ziegler. Woodwardi nuk dëshironte të përsëritej ky episod, sidomos pas bisedës që kishte patur në drekë me Katharine Graham.

Pakula po bënte një film “shokësh” – natyra e çuditshme e Woodsteinit ishte ajo

që kishte nxitur aktorin Robert Redford që të blinte të drejtat e skenarit – dhe regjisori i Hollywoodit padyshim që donte të dinte përse ata ishin grindur aq keq në janar të 1973-shit. Parë në retrospektivë, Watergate ishte në prag të lëshimit të metastazave dhe drejt shndërrimit të skandalit më të madh presidencial që nga Teapot Dome, dhe menjëherë më pas, përpjekja e parë për impeachment ndaj presidentit në 100 vite. Kështu gazetarët e The Post i dhanë Pakulas atë lloj aksesit që i rezervohet vetëm botuesve.

Pasi Newsweek-u u tregoi një draft të këtij artikulli, Woodwardi dhe Bernsteini pranuan se ishte “autentik”. Por ata shtuan se nuk e dinin si e kish shtënë në dorë Pakula draftin e tyre të pabotuar asnjëherë dhe përse ai kishte qenë kaq i interesuar për ta gjetur.

Skandali i Watergate, që vazhdoi për 26 muaj që nga fillimi i tij ishte një sagë jashtëzakonisht shumë komplekse. Megjithatë, për shkak të “Gjithë njerëzve të Presidentit” dhe sidomos përshtatjes së tij në film, e gjithë historia reduktohet shpesh në një fabul të volitshme dhe joshëse, si rrëfim për dy gazetarë të rinj dhe të paepur që rrëzuan një president, duke përdorur të vërtetën si armën e tyre të vetme. Ose si ka thënë kritiku Wilfrid Sheed: “njerëzit ngatërrohen shpesh me detajet e skandalit të Watergate, por të paktën ata mbajnë mend filmin: një çift gazetarësh potorexhinj dhe një informator, apo jo?”

Ata nuk pranuan të diskutojnë zbulimin e identiteteve të vërtetë të burimeve të tyre, pjesërisht sepse shkrimi me dorë në skaje nuk ishte qartësisht i lexueshëm dhe kishte përdorim shkurtimesh. “Për arsye se nuk është e qartë cili është shkrimi i dorës në skaje dhe shkrimi mund të përfshijë burime që mund të jenë ende gjallë”, shkruajnë Woodstein në një email”, “ne nuk mundemi të komentojmë”. Sigurisht, nuk ka pikë rëndësie se kush i shkruajti identitetet në skaje. Ishin vetëm dy njerëz që mund ta kenë zbuluar këtë informacion: njëri prej tyre është Woodward, dhe tjetri është Bernstein. Ata ndoshta kishin pak vështirësi për të kujtuar se kujt i përkisnin shkurtimet, përderisa thanë gjithashtu për Newsweek se drafti i artikullit “tregon edhe një herë që ne kishim disa burime për punën tonë mbi Watergate-n, brenda dhe jashtë qeverisë, prej shumë institucioneve, individëve dhe pikëvështrimeve”.

Përveç këtyre informacioneve se si e ndërtuan artikullin e Watergate-t Woodstein, drafti përcjell edhe një të vërtetë historike të rëndësishme, që e harrojmë shpesh. Skandali i Watergate, që vazhdoi për 26 muaj që nga fillimi i tij ishte një sagë jashtëzakonisht shumë komplekse. Megjithatë, për shkak të “Gjithë njerëzve të Presidentit” dhe sidomos përshtatjes së tij në film, e gjithë historia reduktohet shpesh në një fabul të volitshme dhe joshëse, si rrëfim për dy gazetarë të rinj dhe të paepur që rrëzuan një president, duke përdorur të vërtetën si armën e tyre të vetme. Ose si ka thënë kritiku Wilfrid Sheed: “njerëzit ngatërrohen shpesh me detajet e skandalit të Watergate, por të paktën ata mbajnë mend filmin: një çift gazetarësh potorexhinj dhe një informator, apo jo?”

wat 5Drafti i artikullit e hedh poshtë këtë mit. Dokumenti në letrat e Pakulas, bashkë me sfondin e artikullit, demonstroi se shtatë muaj pasi u kapën keqbërësit në Watergate, shtypi ishte në pozicionin e parabolës së të verbërve dhe elefantit: ende nuk e kish të qartë se çfarë kishte në duar. Woodwardi dhe Bernsteini nuk ishin më pranë zbulimit se kush e miratoi futjen natën në Watergate, nga sa kishin qenë në qershor, dhe ishin edhe më larg madje zbulimit të pengimit të drejtësisë që pasoi këtë ngjarje. Dhe në fund të fundit, ishte pikërisht kjo fshehje që futi në kurth Nixonin dhe vuri në lëvizje sanksionin politik të impeachment-it. Nëse ka tituj për t’u dhënë në lidhje me këtë çështje, ato i përkasin sistemit ligjor, sidomos tre prokurorëve – Glanzerit të sipërpërmendur, Earl J. Silbertit dhe Donald E. Campbellit – të cilët mbyllën vazhdimisht “pincat” ligjore deri kur një prej të akuzuarve për Watergate-n, James Mc Cord, më në fund nisi të flasë jo shumë kohë pas dënimit të tij në janar.

Mediat dhe sidomos Woodstein kanë meritën e madhe që mbajtën gjallë lajmin, sidomos para zgjedhjeve të 1972, atëherë kur ngjarja në Watergate shihej me një kombinim apatie dhe shpërfilljeje. Mospajtimi mes artikujve që dilnin në media dhe “mohimet jomohuese” të Shtëpisë së Bardhë krijuan një hendek besueshmërie. Mbulimi mediatik shërbeu si profilaktik për prokurorët, duke i lejuar të vazhdojnë përpara pa ndërhyrje. Në fund, ishte puna e jurisë së madhe të Watergate dhe këtyre prokurorëve – jo e medias – që prodhoi një shteg drejt të gjithë padive deri kur u emërua një prokuror special në maj 1973.


Bob Woodward dhe Carl Bernstein ishin vetëm dy prej shumë aktorëve në dramën e Watergate-t, dhe ndoshta jo më të rëndësishmit, pavarësisht përpjekjes së Robert Redford për t’i bërë të adhuruar.

Watergate do të jetë gjithmonë një prej momenteve më të lavdishëm të mediave. Por si e tregojnë edhe dokumentat e Pakulas, edhe me gjithë burimet anonimë që kishin Woodstein, merita për drejtësinë e dhënë duhet të ndahet me proceset ligjorë dhe atë në kongres. Epoka e adhurimit të Woodwardit dhe Bernsteinit duhet të marrë fund.

Edhe diçka: “Woodward tani bie dakord që artikulli duhej të kishte dalë”, thanë Bernstein dhe Woodward në përgjigjen e tyre pasi kishin parë draftin e artikullit. Por nëse kjo do të kishte ndodhur, The Washington Post do të ishte dëmtuar shumë. Në numrin e 29 janarit, revista Time botoi po të njëjtat akuza për Mitchell dhe Colson – gjë që nuk të habit po të kesh parasysh që Mark Felt po jepte informacione edhe tek Sandy Smith e Time. Por, pasi Colsoni kërcënoi se do të bënte një padi disa milionë dollarëshe, Time kërkoi shpejt e shpejt falje dhe e tërhoqi artikullin. Colsoni bëri shumë gjëra, duke përfshirë edhe pjesëmarrjen në fshehjen e ngjarjes. Por nuk ka patur asnjëherë prova që ai e ka miratuar që përpara futjen në zyrat e Watergate.

Sa për arsyen përse Mark Felt, ose Deep Throat ishte kaq indiferent për shpërndarjen e kaq shumë informacioneve të këqinj, si për shembull paraqitjen e Colsonit si njeriun kryesor të komplotit... kjo është një tjetër histori. /NEWSWEEK/

PERSHTATUR NE SHQIP NGA: ERMAL GJINAJ / www.bota.al



Vargas Llosa: “Mjaft me pesimizëm. Sepse demokracia s’është e lodhur”

Fituesi i Nobelit ka pagëzuar një neologjizëm për të përcaktuar sëmundjen europiane, “ombligizmin”, nga spanjishtja ombligo, “zakoni i të parit të kërthizës tënde”. Por mund të jetë pikërisht lufta kundër Kalifatit për të bërë “që Europa dhe Perëndimi të hapin sytë për ato gjëra që u rrezikohen, për vlerat etike të lirisë, solidaritetit, respektit të grave që mund t’i humbasim: kemi mposhtur komunizmin, tani duhet të përballemi me fanatizmin fetar”

Mario Vargas Llosa, peruan, mjeshtër i letërsisë, fitues i Cmimit Nobel në vitin 2010 kërkon që të sprapsët pesimizmi që na ka mbërthyer për fyti ne europianëve. Ndoshta sepse e parë nga vendet në zhvillim, bota është më pak në ankth, ndoshta sepse kthjelltësia e mendjes dhe bindjes i shërben si busull. Këto ditë ai

ndodhet në Itali për të marrë pjesë në përvjetorin e dhjetë të krijimit të institutit liberal Bruno Leoni. Për të shprehur idenë që ai ka për botën, në këtë intervistë nxiton menjëherë të thotë që nuk ndan idenë – e hedhur sidomos nga Francis Fukuyama – që demokracia është duke gulçuar dhe që modelet autoritarë si ai kinez, munden që të jenë tërheqës, sepse janë më eficientë. “Është një vizion shumë pesimist. Demokracia ka probleme seriozë, por kam përshtypjen që është totalitarizmi ai që po sprapset”. Përmend Hong Kongun si demonstrim të faktit që “zhvillimi ekonomik, në fund të fundit, është i papajtueshëm me totalitarizmin, hapja ekonomike herët a vonë nxjerr nevojën e një hapjeje politike”. Klasa e mesme e krijuar rishtaz në Kinë do të detyrojë Pekinin drejt reformave demokratike. Dhe në pjesën tjetër të botës, situata nuk është më ndryshe: totalitarizmi nuk përparon.

Rusia e Putinit nuk ka asgjë për të ofruar. Në Amerikën Latine “klime nuk është më në favor të diktaturës”: në Amerikën Qendrore, për herë të parë nuk ka më luftëra civile; në Kolumbi, Peru, Meksikë demokracia po konsolidohet, dhe në vende të tjerë nuk është në rrezik. “Dhe Brazili – vazhdon ai – ka mundësinë, në zgjedhjet që po zhvillon, të rinovohet në krahasim me korrupsionin e qeverive të Dilma Rousseffit dhe Lulës. Është interesant rasti i Marina Silvas (sfiduese për presidencën, e mundur në raundin e parë), e cila është nisur nga ekstremi i majtë, si ekologjiste dhe ka pranuar tashmë se për zhvillimin janë të domosdoshme sipërmarrja, tregu i lirë, hapja. Ka një të majtë që po zbulon rëndësinë e këtyre vlerave, që në Amerikën Latine kanë sot një mbështetje që nuk e kanë patur kurrë më parë. Nëse Marina Silva do e mbështesë seriozisht, mendoj se Aécio Neves mund të bëhet president. Do të ishte shumë pozitive: në përgjithësi besohet se shtetari i madh në Brazil ka qenë Lula. Në të vërtetë shtetari i vërtetë ishte Henrique Cardoso, i cili reformoi, hapi dhe bëri të rritet ekonomia që tani me Dilman është ndalur”.

Vetëm në vendet që kanë ngrirë në të kaluarën situata është pesimiste. “Kuba është e trishtuar, një vend në harresë: e vetmja ëndërr që kanë kubanët është të arratisen në SHBA. Dhe Venezuela në teori është shumë e pasur, por ka inflacionin më të lartë në botë, ekonomia nuk mund të ishte më keq dhe represioni është i ashpër: por, opozita po rritet”. Jo se demokracia nuk ka probleme. “I pari është korrupsioni, që për shembull në Europë është shumë serioz”. Dhe provokon reagime: nacionalizmin, racizmin, “jo masivë, por shqetësues”. Dhe në Perëndim, shton politologu, “asistojmë në një zhdukje të vlerave sepse elitat janë shpesh të korruptuara. Për shembull, sipërmarrja ishte një forcë edhe morale në të kaluarën: sot, lakmia ka arritur të shkatërrojë frenat morale që garantonin funksionimin demokratik”. Pra, liritë ndodhen përballë sfidave serioze, por përballë autoritarizmit, nuk po sprapsen.

Sipas mendimit të Vargas Llosas, Perëndimi nuk ka mbështetur aq sa duhet lëvizjet demokratike të Pranverës Arabe, Obama gaboi që u tërhoq shumë shpejt nga Iraku dhe që nuk mbështeti që në fillim forcat demokratike që synonin rrëzimin e Assadit në Siri. “Tani, fundamentalizmi islamik është një rrezik për kulturën e lirë, për vlerat e Perëndimit” dhe Kalifati tingëllon si folkloristik, por nuk është i tillë. “Na ka shpallur një luftë: o e fitojmë, o e humbim”. Sigurisht, nuk do të jetë e lehtë: në Europë, qytetarët, qeveritë, intelektualët e kanë humbur idealizmin, ka zënë vend një pesimizëm apatik që nuk arrin të mbrojë vlerat liberale. Fituesi i Nobelit ka pagëzuar një neologjizëm për të përcaktuar sëmundjen europiane, “ombligizmin”, nga spanjishtja ombligo, “zakoni i të parit të kërthizës tënde”. Por mund të jetë pikërisht lufta kundër Kalifatit për të bërë “që Europa dhe Perëndimi të hapin sytë për ato gjëra që u rrezikohen, për vlerat etike të lirisë, solidaritetit, respektit të grave që mund t’i humbasim: kemi mposhtur komunizmin, tani duhet të përballemi me fanatizmin fetar”. Nga njëra anë edhe duke i zhdukur terroristët. Nga ana tjetër, duke ndihmuar Islamit që të eksperimentojë një proces

laicizimi: “të gjithë fetë lindin totalitare, por kristianizmi është laicizuar, islami jo”.

Në lidhje me fenë, sipas Vargas Llosas, papa Francesku është një forcë progresiste që ka një ndikim të madh edhe gjeopolitik. Por është i frenuar nga struktura konservatore e Kishës, nga Curia romane që ia ndal vullnetin reformues. “Në Kishë ka njerëz të mrekullueshëm – thotë – por edhe shpellarë; shpresojmë që të arrijë t’i kapërcejë. Dhe do i këshilloja Papës të mos flasë për ekonominë: ka specialistë, përse duhet të shqetësohet?”

Mesazhi i fortë që intelektuali peruan dëshiron të përcjellë për europianët është se “çarmatimi moral që përjetojnë, cinizmi, ideja që çdo gjë është e korruptuar dhe shkon keq bën të humbasë ai dinamizëm që në të kaluarën ka qenë faktori i madh i ndryshimit dhe reformave. Është një problem thellësisht kulturor, fryme kritike”. /Corriere della Sera/

PERSHTATUR NE SHQIP NGA www.bota.al